



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 736 Akti

Nr. 797 Vendimi
Tiranë, më 9.9.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu Kryesuese
Brunilda Bektashi Relatore
Olsi Komici Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 9.9.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Alma Troshani**, me detyrë ndihmëse ligjore¹ pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998”, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneres Brunilda Bektashi, mori në shqyrtim dhe analizoi çështjen në tërësi,

¹ aktualisht ndihmëse inspektore në ILD.

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Alma Troshani, me detyrë ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, referuar pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK, ish-Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar); Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni ka zhvilluar shortin në datën 15.6.2021, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Troshani, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Suela Zhegu, Brunilda Bekteshi dhe Olsi Komici. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Brunilda Bekteshi.

4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 21.6.2021, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Alma Troshani, si dhe caktoi kryesuese të trupit gjykues komisioneren Suela Zhegu. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

5. Subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur lidhur me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesës së Komisionit, në datën 9.7.2021 (me e-mail datë 12.7.2021) ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

6. Në datën 19.7.2024, Komisioni me vendimin nr. 2 vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Alma Troshani për të tria kriteret e rivlerësimit, vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe të paraqesë pretendimet e saj brenda datës 2.9.2024 nga marrja e njoftimit me postë elektronike, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 22.7.2024, subjekti i rivlerësimit u njoftua lidhur me: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të sjellë prova për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit. Në datën 30.8.2024, subjekti dërgoi në rrugë elektronike shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ.

8. Në datën 3.9.2024, trupi gjykues me vendimin nr. 3 vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Alma Troshani në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Në datën 3.9.2024, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më 9.9.2024, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Alma Troshani u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Alma Troshani. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 9.9.2024, për të rifilluar po në datën 9.9.2024 për shpalljen e vendimit në orën 11:00.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

11. Znj. Alma Troshani ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur, kur i është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj saj.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

12. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas krerëve IV, V dhe VI të këtij ligji. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLGJ-ja është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese² dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

13. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Troshani, me nr. ***, datë 8.1.2018, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i

² Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore, që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ku subjekti në datën 27.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu dhe për personat e lidhur me të, për vlerësimin e pasurisë ky institucion ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

14. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas mbylljes së hetimit administrativ; (d) shpjegimet e dhëna në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

15. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijuarit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

16. Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, sipas formularit (shtojca nr. 2) datë 27.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë deklaruar në deklaratën *Vetting* pasuritë si vijon:

17. Apartament në bashkëpronësi me bashkëshortin me sipërfaqe 54.45 m², nr. pasurie ***, vol. ***, faqe ***, z. k. ***, vërtetuar kjo me certifikatën e pronësisë nr. ***, datë lëshimi 10.9.2012. Vlera: 5.700.000 lekë. Pjesa në zotërim: 50%. Si burim për krijimin e kësaj pasurie ka shërbyer kredia e marrë pranë BKT-së, në shumën 3.801.814 lekë, me afat 25-vjeçar, vërtetuar kjo me kontratën e kredisë bankare për blerjen e shtëpisë, bashkëlidhur këtij deklarami. Gjithashtu, si burim krijimi i kësaj pasurie kanë shërbyer edhe të ardhurat nga paga e dhurimi i bërë nga vjehrra L.T, vërtetuar kjo me deklaratat noteriale 16.7.2012 dhe 24.7.2012 dhe nga mandati bankar, bashkëlidhur këtij deklarami. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³.

³ Certifikatë pronësie për pasurinë “apartament” me sipërfaqe 54.45 m², nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, z. k. ***, në S, Tiranë, në emër të shtetasve Alma dhe E.T, lëshuar në datën 10.9.2012, si dhe kartela e pasurisë së apartamentit me vlerë 5.700.000 lekë, pasuri e ngarkuar me barrë hipotekore në datën 9.8.2012, në favor të BKT-së, për shumën 3.928.000 lekë. Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.7.2012, me deklaruese shtetasen L.T, e cila djalit të saj E.T dhe nuses së djalit Alma Troshani i dhuron shumën 370.000 lekë, shumë e cila do të shërbejë për pagesën e kështit II, për blerje apartamenti me sip. 54.45 m². Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.7.2012, me deklaruese shtetasen L.T, e cila djalit të saj E.T dhe bashkëshortes së djalit Alma Troshani i dhuron shumën 1.400.000 lekë, shumë e cila do të shërbejë për pagesën e kështit I për blerje apartamenti me sip. 54.45 m² të blerë prej tyre. Mandatpagesë e datës 13.7.2012, e Credins

17.1 ILDKPKI-ja në raportin e tij është shprehur: “Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë justifikues ligjor lidhur me mundësinë financiare të shtetas L.T (nëna e bashkëshortit) për dhurimin e bërë në shumën totale 1.770.000 lekë”.

Hetimi i Komisionit

17.2 Apartamenti në bashkëpronësi me bashkëshortin, me sipërfaqe 54.45 m², është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2012. Në rubrikën përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit, subjekti ka deklaruar: apartament me sipërfaqe 54.45 m², ndodhur në z. k. ***, vol. ***, fq. ***, vërtetuar me certifikatën e pronësisë të lëshuar nga ZVRPP Tiranë, datë 10.9.2012, në bashkëpronësi me bashkëshortin. Vlera: 5.700.000 lekë. Pjesa në zotërim: 50%. Kjo pasuri është fituar nëpërmjet blerjes nga shtetasit SH dhe J.T me kontratën e shitjes me rezervë të datës 11.7.2012. Burim të krijimit të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar: “Ky apartament është blerë pjesërisht me kredi në vlerën 3.928.000 lekë të marrë nga BKT, si dhe dhurimi i bërë nga vjehrra L.T, vërtetuar kjo me deklaratat noteriale datë 16.7.2012 për vlerën 1.400.000 lekë dhe datë 24.7.2012 për vlerën 370.000 lekë”.

17.3 ZQRPP-ja⁴ ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Tiranë, e cila informon se në emër të shtetasve Alma S. Troshani dhe E.H.T rezulton pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, z. k. ***, në S, lloji apartament, me sipërfaqe 54.45 m².

17.4 Nga verifikimi i dosjes së administruar për këtë pasuri rezulton se ajo është përfituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me rezervë⁵ nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.7.2012, me palë shitëse J.T dhe palë blerëse Alma dhe E.T. Çmimi i shitjes së pasurisë është në vlerën 5.700.000 lekë. Sipas kontratës, pagesa është parashikuar që do të paguhet nga blerësit e ndarë në dy këste: kësti i parë në shumën 1.400.000 lekë do t’i paguhet shitësit deri në datën 25.7.2012, ndërsa kësti i dytë në shumën 4.300.000 lekë do t’i paguhet shitësit prej blerësve me kredi bankare, nëpërmjet Bankës Kombëtare Tregtare, deri në datën 20.8.2012. Kalimi i pronësisë së apartamentit do të bëhet në emër të blerësve pas pagesës së kështit të parë, si dhe nga ana e bankës do të bëhet lëvrimi i kredisë në shumën 4.300.000 lekë, në favor të shitësit.

17.5 Rezerva e përcaktuar në kontratë ka qenë parashikimi i kalimit të pronësisë në favor të blerësve pas shlyerjes së kështit të parë. Kjo me qëllim vendosjen e pasurisë si kolateral për përfitimin e kredisë dhe, më tej, shlyerjen e kështit për shitësit e pasurisë.

17.6 UKT Tiranë⁶ informon se në emër të shtetas Alma S. Troshani nuk rezulton asnjë e dhënë apo kontratë e regjistruar me Shërbime Ujësjellës – Kanalizime sh.a.

17.6.1 Komisioni i ka kërkuar subjektit të depozitojë kontratën ose faturat e pagesës për shërbimin e marrë dhe në përgjigje subjekti⁷ ka depozituar: i) kontratën me nr. *** lidhur mes saj dhe UKT-së për apartamentin objekt hetimi; ii) librezë uji në emër të saj; iii) printime nga sistemi i UKT-së, ku rezulton se nuk ka detyrime.

17.7 FSHU-ja⁸ informon se në emër të shtetas Alma S. Troshani rezulton një abonent me kontratë furnizimi nr. ***, në instancën Tiranë. Nga të dhënat vihet re se kjo kontratë është në emër të shtetas

Bank, “tërheqje cash” 700.046,36 lekë nga L.T, si dhe kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.10.2004, për shitje apartamenti sip. 83 m², në Shkodër, me palë shitëse H.T, L.T e DH.T dhe blerës D.V, me çmim 500.000 lekë (aneks nr. ***, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 26.10.2017, ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Tiranë, nr. *** prot., datë 24.10.2017 (aneks nr. ***, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

⁵ Administruar në praktikën e ZVRPP-së (aneks nr. ***, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 2.8.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 27.5.2024.

⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 26.7.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

Alma S. Troshani, në adresën S, kategoria familjare, statusi aktiv dhe nr. identifikues ***, çka korrespondon me ID-në e subjektit të rivlerësimit.

17.8 Në lidhje me analizimin e burimit të krijimit të kësaj pasurie

17.8.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi për pasurinë apartament si në deklaratën periodike të vitit 2012, edhe në atë *Vetting* dhurimin e kryer nga vjehrra e saj, shtetasja L.T, vërtetuar kjo me deklaratat noteriale datë 16.7.2012 për vlerën 1.400.000 lekë dhe datë 24.7.2012 për vlerën 370.000 lekë, si dhe kredinë në BKT, në shumën 3.928.000 lekë.

17.9 Në lidhje me shumat 1.400.000 lekë dhe 370.000 lekë, dhuruar nga vjehrra e subjektit të rivlerësimit, znj. L.T

i) Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.7.2012, të znj. L.T, në të cilën deklaroi se i ka dhuruar djalit të saj E.T dhe nuses së djalit Alma Troshani shumën 1.400.000 lekë, me qëllim pagimin e këstit të parë për blerjen e një apartamenti të ndodhur në S, Tiranë, shkalla ***, k. ***, ap. ***, me sipërfaqe 54.45 m² sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me rezervë nr. *** rep., *** kol., datë 11.7.2012. Subjekti ka depozituar deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.7.2012⁹ të znj. L.T, në të cilën deklarohet e njëjta përmbajtje si në deklaratën e dhurimit të parë, por duke përcaktuar se shuma 370.000 lekë shërben për pagimin e diferencës së këstit të dytë të pasurisë.

ii) Komisioni e ka pyetur¹⁰ subjektin lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre shumave dhe, në përgjigje, subjekti ka deklaruar dhe dokumentuar se vjehrra e vjehri i saj kanë krijuar të ardhura nga punësimi, më pas të ardhura nga pensioni, si dhe nga shitja¹¹ e pasurisë apartament me sipërfaqe 83 m², në Shkodër, në vlerën 500.000 lekë¹².

iii) Ndër të tjera, subjekti ka sqaruar¹³ se familja e bashkëshortit ka përfutur të ardhura “...edhe nga dhënia me qira e dyqanit, të deklaruar prej bashkëshortit tim E.T në Deklaratën *Vetting*, si pasuri që rrjedh nga trashëgimia, të cilin ata e kanë pasur në proces legalizimi dhe që më pas është legalizuar. Nëna e bashkëshortit më ka sqaruar se ky dyqan ka qenë i dhënë me qira që në vitin 2006 dhe nga kjo pasuri ajo dhe bashkëshorti i saj kanë marrë qira në vlerën 10.000 lekë në muaj, por lidhja e kontratës është mundësuar shumë vite më pas, kur procedurat po shkonin drejt legalizimit të ndërtesës dhe më ka vënë në dispozicion kontratën e qirasë datë 21.8.2017, të lidhur mes saj dhe qiramarrëses B.H, nënshkrimi i së cilës është vërtetuar prej vërtetimit të nënshkrimit nr. *** rep., datë 21.8.2017, nga noterja O. K, të cilin po jua përcjell bashkëlidhur. Nëna e bashkëshortit më ka sqaruar gjithashtu se vjehri edhe pas daljes në pension, në datën 28.3.2007, ka vijuar ta ushtrojë zanatin e tij si elektrikist, por për shkak se ai ka ndërruar jetë dhe vjehrra nuk e kujton biznesin privat ku ai ishte i punësuar, jam në pamundësi të siguroj dokumentacion, për shkak se siguracionet e para vitit 2011 gjenden në Arkivin Lundër dhe kërkojnë domosdoshmërisht të dhëna të biznesit për të më mundësuar me dokumentacion”.

iv) Nga hetimi ka rezultuar se vjehrra e subjektit, shtetasja L.T, ka kryer transaksionet e mëposhtme në bankat e nivelit të dytë:

⁹ Me këtë deklaratë shtetasja L.T ka bashkëngjitur faturën e Credins Bank, me të cilën provon se ka tërhequr në datën 13.7.2012 shumën 700.046,36 lekë.

¹⁰ Me pyetësorin nr. 2, datë 27.5.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

¹¹ Kontratë për shitblerje pasurie të paluajtshme, apartament banimi nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë 5.10.2004.

¹² Subjekti përmes shpjegimeve të saj në datën 19.7.2024 sipas kërkimit të Komisionit ka provuar pagesën e tatimit për këto të ardhura (mandatarkëtim nr. ***, datë 8.10.2004, referuar legjislacionit tatimor të kohës).

¹³ Me pyetësorin nr. 4, datë 28.6.2024.

- Në Credins Bank ka depozituar në datën 29.1.2007 shumën 900.000 lekë. Kjo shumë është investuar në depozitë dhe ka përfituar interesa për periudhën 2007 – 2012 në vlerën 156.405,86 lekë. Më pas, depozita është tërhequr në datën 13.7.2012, në vlerën 700.043,36 lekë.

- Në Credins Bank ka depozituar në datën 12.7.2012 shumën 670.000 lekë dhe ka tërhequr një ditë më pas, në datën 13.7.2012, shumën 669.500 lekë.

- Në BKT, në llogarinë bankare të djalit të saj E.T (bashkëshorti i subjektit), ka depozituar në datën 24.7.2012 shumën 370.000 lekë.

v) Në analizë të dokumentacionit të depozituar, por edhe nga hetimi i Komisionit rezulton se familja e bashkëshortit ka përfituar të ardhura si më poshtë detajuar:

- Nëna e bashkëshortit ka përfituar të ardhura nga pensioni¹⁴ në shumën 1.943.439 lekë për periudhën qershor 1993 – korrik 2012;

- Babai i bashkëshortit ka përfituar të ardhura bruto nga punësimi¹⁵ në shumën 1.417.359 lekë për periudhën janar 1994 – korrik 2003;

- Babai i bashkëshortit ka përfituar të ardhura nga pensioni¹⁶ në shumën 1.154.636 lekë për periudhën mars 2007 – korrik 2012;

- Të ardhura nga shitja¹⁷ e pasurisë së paluajtshme apartament, në vitin 2004, në vlerën 500.000 lekë;

- Të ardhura nga interesat nga depozita në Credins Bank për periudhën 2007 – korrik 2012, në shumën 156.406 lekë.

vi) Komisioni kreu përlllogaritjet e të ardhurave të ligjshme të dokumentuara, duke mos përfshirë në këtë analizë të ardhurat e pretenduara të përfituara nga puna si elektrikist të vjehrrit të subjektit pas vitit 2007, si dhe të ardhurat nga dhënia me qira e dyqanit, pasi nuk provohej me dokumentacion marrëdhënia e punësimit dhe qiradhënies, si dhe shuma e përfituar për periudhën e analizuar. Pas përlllogaritjeve të kryera nga Njësia e Shërbimit Ligjor, Komisioni konstatoi se familja e bashkëshortit ka përfituar të ardhura të ligjshme në shumën 5.171.840 lekë, shumë e cila në raport me shpenzimet e jetesës rezulton e mjaftueshme për të dhuruar shumën prej 1.770.000 lekësh nga vjehrra e subjektit. Në analizë të fakteve të dala, Komisioni nuk konstatoi problematika mbi burimin e krijimit dhe mjaftueshmërinë për shumën e dhuruar në analizë dhe as lidhur me deklarin e saj.

17.10 Në lidhje me burimin tjetër të krijimit të pasurisë, kredi e marrë në BKT

i) Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë këtë kredi në deklaratën periodike vjetore për vitin 2012 në rubrikën e detyrimeve financiare me përshkrimin “Kredi pranë BKT në shumën 3.928.000 lekë”.

ii) Gjithashtu, subjekti këtë kredi e ka deklaruar edhe në rubrikën e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme si burim për pasurinë apartament me sip. 54.45 m² me përshkrimin “Ky apartament është blerë pjesërisht me kredi, vlera prej 3.928.000 lekësh marrë kredi nga BKT, vërtetuar nëpërmjet kontratës së kredisë”.

iii) Nga korrespondenca e Komisionit me BKT¹⁸, kjo e fundit informon se shtetasja Alma S. Troshani ka kredi pranë kësaj banke në shumën 3.928.000 lekë, datë lëvrimi 15.8.2012, dorëzanës E.H.T dhe kolateral për sigurimin e kredisë apartament me sip. 54.45 m², z. k. ***, nr. pasurie ***.

¹⁴ Vërtetim nr. *** prot., datë 2.8.2021, nga ISSH DR Shkodër, depozituar nga subjekti i rivlerësimit me pyetësin nr. 2.

¹⁵ Vërtetim për bazën e vlerësueshme, me punëdhënësin OSHEE sh.a., depozituar nga subjekti me pyetësin nr. 2.

¹⁶ Vërtetim nr. *** prot., datë 2.8.2021, nga ISSH DR Shkodër, depozituar nga subjekti i rivlerësimit me pyetësin nr. 2.

¹⁷ Kontratë për shitblerje pasurie të paluajtshme, apartament banimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.10.2004.

¹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 9.8.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

iv) Nga administrimi i dosjes së kredisë nga BKT, por edhe dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit me deklaratën *Vetting*¹⁹, rezulton se është nënshkruar kontratë kredie bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.8.2012, lidhur mes Bankës Kombëtare Tregtare, kredimarrëses Alma Troshani dhe dorëzuesve E.T, J.T dhe SH.T.

v) Nga analizimi i kontratës konstatohet se subjekti e ka përfituar këtë kredi në kushte lehtësuese. Komisioni kërkoi²⁰ shpjegime dhe, ndër të tjera, subjekti ka sqaruar dhe dokumentuar se: *“Në fazën e parë të aplikimit (viti 2011), pranë Njësisë Bashkiake Nr. ***, ku ishim të regjistruar në momentin e aplikimit, kam paraqitur kërkesë për t’u trajtuar me strehim në bazë të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, ku kam kërkuar të trajtohem me banesë sociale me kosto të ulët (si e pastrehë) si një nga format e trajtimit, sipas njerit prej programeve sociale të strehimit.*

*Më pas, në fazën e dytë gjatë përzgjedhjes në Bashkinë Tiranë, kam plotësuar përpara noterit deklaratën noteriale nr. *** rep., datë 24.10.2011, ku kam bashkëlidhur gjithë dokumentacionin ligjor të kërkuar për të përfituar kredi në kushte lehtësuese dhe e kam depozituar pranë Bashkisë Tiranë, duke depozituar ndër të tjera edhe akte të lëshuara nga ZVRPP-ja Tiranë (sot ASHK Tiranë) dhe ZVRPP-ja Shkodër (sot ASHK Shkodër), sipas të cilave në emër timin dhe të bashkëshortit nuk figuronte e regjistruar asnjë pronë, konkretisht:*

*Ju sqaroj se pas përpilimit të plotë të dokumentacionit dhe shqyrtimit nga autoritetet përkatëse, me vendim të Këshillit Bashkiak nr. ***, datë 5.4.2012 “Për trajtimin e familjeve që përfitojnë nga projekti për subvencionimin e kredive”, më është miratuar kërkesa, ku në listën bashkëlidhur këtij vendimi unë jam e ***-ta në listë. Më pas i jam drejtuar bankës, ku kam përfituar kredi të subvencionuar nga shteti pjesërisht, ku për mua çdo muaj kësti që paguaj pranë BKT është thujse i palëvizshëm, përafërsisht 18500 lekë deri në 18700 lekë në muaj, nga momenti i përfitimit të kësaj kredie deri në momentin e daljes sime në pension”.*

Në mbështetje të deklaratimit, subjekti ka depozituar edhe dokumentacionin provues për përfitimin e kësaj kredie me kushte lehtësuese.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se subjekti e ka përfituar këtë kredi në kushtet e të pastrehut, duke mos pasur një pronë, si dhe të ardhura te mjaftueshme pranë Bashkisë Tiranë sipas kriterëve të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, dhe jo kredi lehtësuese për shkak të detyrës.

vi) Për këtë kredi është lidhur kontratë hipoteke nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.8.2012, ku hipotekë është vendosur pasuria e paluajtshme objekt vlerësimi, apartament me sipërfaqe 54.45 m², e regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. pasurie *** vol. ***, faqe ***, z. k. ***, me adresë sh. ***, k. ***, ap. ***, S, Tiranë.

vii) Nga analizimi i *statement*-it rezulton se kredia është disbursuar në datën 15.8.2012, në vlerën 3.928.000 lekë dhe, në datën 16.8.2012, subjekti i rivlerësimit Alma Troshani ka kaluar në favor të shtetasve J ose SH.T shumën 3.928.000 lekë me përshkrimin “Likuidim kësht kredie sipas kontratës së shitjes me kusht nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.7.2012 (notere M.B)”.

Në analizë të të dhënave të përfituara nga hetimi, Komisioni konstatoi se kjo kredi është përfituar sipas kriterëve të ligjit të kohës, është akorduar nga një institucion financiar, si dhe ka kaluar me transfertë bankare tek pala shitëse. Në këto kushte, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me përfitimin e kësaj kredie dhe ligjshmërinë e saj.

17.11 Në lidhje me likuidimin e kësaj pasurie

¹⁹ Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁰ Me pyetësorin nr. 4, datë 28.6.2024.

i) Sipas kontratës së shitjes, kësti i parë në shumën 1.400.000 lekë do t'i paguhet shitësit deri në datën 25.7.2012, ndërsa kësti i dytë në shumën 4.300.000 lekë do t'i paguhet shitësit prej blerësve me kredi bankare, nëpërmjet Bankës Kombëtare Tregtare, deri në datën 20.8.2012.

ii) Nga hetimi rezultoi se vjehrra e subjektit L.T ka tërhequr nga llogaria e saj bankare në Credins Bank shumat 700.043,36 lekë dhe 669.500 lekë në datën 13.7.2012. Më pas, në datën 16.7.2012, ajo ka lëshuar deklaratën noteriale për dhurimin e shumës 1.400.000 lekë djalit dhe nuses së djalit, me qëllim pagimin e këstit të parë të apartamentit.

iii) Ndërsa në datën 24.7.2012 L.T ka derdhur në llogarinë e të birit E.T, në BKT, shumën 370.000 lekë. Po në këtë datë, shtetasja L.T ka lëshuar deklaratën noteriale për dhurimin e shumës 370.000 lekë djalit dhe bashkëshortes së tij, me qëllim pagimin e këstit të dytë të apartamentit. Në datën 27.7.2012, E.T e ka transferuar shumën 372.000 lekë në favor të shtetasve J dhe SH.T me përshkrimin kësti i dytë i apartamentit sipas kontratës së shitjes me rezervë nr. rep. ***, nr. *** kol., datë 11.7.2012.

iv) Kësti i fundit është paguar me kredinë e marrë pranë BKT, konkretisht në datën 16.8.2012 subjekti i rivlerësimit Alma Troshani ka transferuar në favor të shtetasve J ose SH.T shumën 3.928.000 lekë, me përshkrimin "Likuidim këst kredie sipas kontratës së shitjes me kusht nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.7.2012".

17.12 Komisioni kreu analizën financiare për vitin 2012, kur është kryer investimi për blerjen e apartamentit, duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuara dhe ka rezultuar si më poshtë pasqyruar. Lidhur me të ardhurat nga punësimi për bashkëshortin e subjektit, rezulton se ai është siguruar me pagë minimale, 20.000 lekë në muaj, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ai ka pasur një pagë mujore prej 35.000 lekësh. Komisioni ka përfshirë në analizë pagën neto sipas asaj të siguruar dhe jo sipas deklaratimit të bashkëshortit.

17.12.1 Nga përlllogaritjet financiare të kryera, Komisioni konstatoi se dukej se subjekti ishte në pamundësi financiare në shumën 14.256 lekë për të përballuar shpenzimet e tjera familjare, duke i kaluar barrën e provës për të provuar të kundërtën e këtij konstatimi.

17.12.2 Në qëndrimin e saj, subjekti ka kundërshtuar përlllogaritjet e Komisionit lidhur me të ardhurat nga punësimi të bashkëshortit, që sipas saj duhet të përlllogariten sipas pagës reale që bashkëshorti i saj ka pasur pranë punëdhënësit në shumën prej 35.000 lekësh në muaj. Lidhur më këtë kërkim, subjekti ka parashtruar se sipas vërtetimit²¹ të lëshuar nga administratori i "****" sh.p.k./punëdhënësi, rezulton se efektivisht bashkëshorti i saj ka pasur një pagë mujore prej 35.000 lekësh. Sipas subjektit, mangësitë e subjekteve tregtare në derdhjen e sigurimeve, mosdeklarimi i saktë nga ana e tyre në organet tatimore dhe sigurimet shoqërore nuk mund të përbëjë shkak për penalizimin e punëmarrësit, në rastin konkret bashkëshortit të saj, si dhe subjektit të rivlerësimit.

17.12.3 Subjekti ka kontestuar edhe përlllogaritjet e shpenzimeve të jetesës sipas ILDKPKI-së për vitin 2012 në vlerën 564.096 lekë, duke referuar dy vendime²² të Komisionit për subjekte të tjera rivlerësimi, ku sipas këtij të fundit janë përlllogaritur në vlerë më të ulët. Sipas subjektit, zërat e shpenzimeve të llogaritura sipas metodologjisë nga ILDKPKI-ja për person, nuk rezultojnë që realisht të konsumohen nga një fëmijë 4-vjeçar (të tilla shpenzime janë ato për arsim, pije alkoolike, transport, duhan, argëtim, komunikim, restorante, hotele etj).

17.12.4 Trupi gjykues, në analizë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të rezultuara gjatë hetimit administrativ, shpjegimeve të subjektit, dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, si dhe në prapësime, arsyeton si vijon:

²¹ Depozituar nga ana e saj në deklaratën periodike të vitit 2012 pranë ILDKPKI-së si avokat shteti dhe në deklaratën *Vetting*.

²² Vendimi nr. 776, datë 24.6.2024, i Komisionit dhe vendimi nr. 775, datë 14.6.2024.

17.12.5 Lidhur me pretendimin e subjektit për përfshirjen në analizë të të ardhurave të bashkëshortit sipas pagës reale që ka pasur pranë punëdhënësit, në shumën prej 35.000 lekësh në muaj, trupi gjykues çmon se këto të ardhura nuk plotësojnë kriteret ligjore sipas nenit D të Kushtetutës, duke e vlerësuar këtë rrethanë edhe nga fakti se subjekti nuk provoi padijeninë për mospagimin e sigurimeve dhe detyrimeve tatimore mbi pagën reale nga punëdhënësi apo se ka qenë në kushtet e keqbesimit.

17.12.6 Lidhur me pretendimin e subjektit për reduktim të shpenzimeve të jetesës sipas ILDKPKI-së për vitin 2012, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim nuk mund të merret në konsideratë, pasi përlllogaritja e tyre i referohet një standardi të vendosur në jurisprudencën e procesit të rivlerësimit, ku shpenzimet e jetesës për çdo subjekt rivlerësimi janë marrë sipas statistikave të INSTAT dhe nuk ndryshojnë sipas rretheve apo moshës së anëtarëve të familjes. Metodologjia e përdorur nga Komisioni është e njëjtë për të gjitha subjektet e rivlerësimit, pasi ato janë një mesatare e totalit të kostove në rang vendi dhe vlerat e përlllogaritura në rastin e subjektit të rivlerësimit u përkasin shpenzimeve mesatare mujore për konsum për familje me 4 anëtarë.

17.12.7 Gjithashtu, trupi gjykues verën se edhe pretendimi i subjektit, ku sipas saj në subjekte të tjera rivlerësimi shpenzimet janë përlllogaritur në vlerë më të ulët, nuk gjendet i bazuar, pasi në vendimin nr. 776, datë 24.6.2024, të Komisionit²³, të cituar prej subjektit, shpenzimet jetike janë përlllogaritur po sipas të njëjtës metodologji. Në rastin e cituar prej subjektit, ku pretendohet se shpenzimet e jetesës për dy anëtarë janë më të ulëta, ky pretendim nuk qëndron, pasi përbërja familjare e subjektit të përmendur ka qenë me 2 anëtarë vetëm për një muaj dhe jo për të gjithë vitin 2012, krahasimisht me përbërjen familjare të subjektit, e cila përbëhet prej katër anëtarësh për të gjithë vitin 2012.

17.12.8 Në përfundim, për sa u parashtrua dhe u analizua më sipër, trupi gjykues rikonstaton se balanca negative në shumën 14.256 lekë mbetet e pandryshuar, e cila është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes, që janë përcaktuese për vlerësimin e kriterit të pasurisë apo procesin e rivlerësimit për këtë subjekt.

17.13 Në lidhje me deklarin e adresës së banimit

17.13.1 Ka rezultuar se në deklaratën periodike vjetore të pasurisë të vitit 2012 dhe në deklaratat në vazhdim subjekti ka deklaruar si adresë banimi adresën e apartamentit të blerë me nr. pasurie ***, vol. ***, faqe ***, z. k. ***, rruga “****”, S, Tiranë. Në pyetësonin standard, subjekti ka deklaruar se është banore në rrugën “****”, nd. ***, hyrja ***, ap. ***, F, S, adresë kjo e cila sot referuar ndryshimeve në adresarin e Tiranës ka këtë emërtim, ndërsa më parë quhej rruga “****”. Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti ka depozituar vërtetimin²⁴ përkatës, ku konfirmohet ky fakt. Për sa më sipër, nuk janë konstatuar problematika lidhur me deklarin e adresës së banimit.

18. Automjet (veturë) tip “Nissan Micra”, me targë *, me vlerë 850 euro. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente²⁵.**

18.1 ILDKPKI-ja në raportin e tij është shprehur: “Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR-ja”.

Hetimi i Komisionit

²³ Me të njëjtën përbërje të trupit gjykues.

²⁴ Datë 21.7.2021, i Njësisë Administrative Nr. ***, Tiranë.

²⁵ Kontratë shitblerjeje automjeti me rezervë, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.12.2016, tip “Nissan Micra”, me targë ***. Vlerë 850 euro. Palë shitëse L.R e palë blerëse E.T, si dhe certifikatën e pronësisë së automjetit me targë ***, e datës 19.12.2016. Kontratë shitjeje automjeti tip “Ford”, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.4.2013, me targë ***, me palë shitëse E.T, me çmim shitjeje 750 euro (aneks nr. ***, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

18.2 Automjetin tip “Micra”, me targë ***, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë në deklaratën *Vetting*. Në rubrikën përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit të saj, subjekti ka deklaruar: “Automjet (veturë) marka Nissan, tipi “Micra”, me targë ***. Vlera e blerjes 850 euro”.

18.3 Rezulton se subjekti nuk e ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie. Komisioni e ka pyetur subjektin lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe në përgjigjen e dhënë²⁶ subjekti ka deklaruar: “Burim për krijimin e kësaj pasurie kanë qenë kursimet familjare të përfuara nga të ardhurat nga paga ndër vite të miat dhe të bashkëshortit tim, E.T”.

18.4 Nga korrespondenca e Komisionit me DPSHTRR-në, kjo e fundit²⁷ informon se E.T ka të regjistruar në DRSHTR Tiranë automjetin me targë ***.

18.5 Komisioni analizoi dokumentacionin e plotë të përcjellë nga DPSHTRR-ja²⁸, nga ku rezultoi se automjeti tip “Nissan Micra”, me targë ***, është blerë nga bashkëshorti i subjektit me kontratën e shitjes me rezervë nr.*** rep., nr. *** kol., datë 9.12.2016, për vlerën 850 euro, nga shtetasja L.L.L.R. Në dosjen e automjetit është administruar edhe certifikata e pronësisë së automjetit me targë ***, e datës 19.12.2016. Sipas kësaj kontrate, rezerva ishte se: “Në rast se nuk bëhej i mundur ndërrimi i lejes së qarkullimit në emër të palës blerëse për arsye të ndonjë problemi ligjor në dokumentacionin e këtij automjeti, çdo gjë mes palëve kthehet në gjendjen fillestare”.

18.6 Komisioni kreu analizën financiare duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuar për të parë mundësitë e subjektit për të investuar në këtë pasuri. Lidhur me të ardhurat nga punësimi për bashkëshortin e subjektit, rezulton se ai është siguruar me pagë minimale, në masën 22.000 lekë në muaj, ndaj Komisioni ka përfshirë në analizë pagën neto sipas asaj të siguruar.

18.7 Nga përlllogaritjet financiare të kryera për periudhën e analizuar, Komisioni konstatoi se subjekti është në pamundësi financiare në shumën 352.094 lekë për të investuar në blerjen e automjetit, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare.

18.8 Në qëndrimin e saj, subjekti ka parashtruar të njëjtat pretendime si në pikat 17.12.2, 17.12.3. Gjithashtu, subjekti ka parashtruar se sipas vërtetimeve të pagave të dorëzuara²⁹ rezulton se familja e saj ka pasur mundësi të grumbullojë shumën e shpenzuar për blerjen e këtij automjeti. Sipas subjektit, në analizën financiare të kryer nga Komisioni, ajo ka rezultuar me bilanc pozitiv për vitin 2013 në vlerën 377.512 lekë, bilanc pozitiv, i cili logjikisht duhet të mbartet në vitet pasardhëse, përfshirë vitin 2015 dhe 2016.

18.9 Trupi gjykues, lidhur me pretendimet e subjektit për përlllogaritje nga Komisioni të pagës reale të marrë prej bashkëshortit dhe reduktimit të shpenzimeve të jetesës, i qëndron të njëjtit arsyetim, duke çmuar të mos bjerë në përsëritje.

18.10 Ndërsa sa i takon pretendimit që balanca pozitive e vitit 2013 duhet të mbartet në vitet që pasojnë, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Rezultati pozitiv i pasqyruar në vitin 2013 është bazuar në të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ka qenë subjekt deklarues për shkak të funksionit të mëparshëm dhe, nëse vlera e pasqyruar në rezultatin pozitiv të vitit 2013 do të ekzistonte, ajo duhet të ishte deklaruar si gjendje *cash*-i nga ana e subjektit ose do të ishte në bankë, ndërkohë që vlera e deklaruar *cash* prej subjektit për vitin 2013 është vetëm 200.000 lekë.

²⁶ Me pyetësorin nr. 3, datë 6.6.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

²⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.7.2021.

²⁸ Me shkresën nr. *** prot. datë 28.8.2024.

²⁹ Në deklaratën *Vetting* dhe pyetësorin nr. 3.

18.11 Në analizë të arsyetimit të mësipërm, trupi gjykues konstaton se balanca negative në shumën 352.094 lekë për të investuar në blerjen e automjetit dhe përballuar shpenzimet e tjera mbetet e pandryshuar, e cila është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes të procesit të rivlerësimit për këtë subjekt.

19. Gjendje cash në banesë, 150.000 lekë

19.1 ILDKPKI-ja në raportin e tij është shprehur: “Subjekti ka deklaruar të ardhura të mjaftueshme për të krijuar gjendjen cash të deklaruar”.

19.2 Rezultoi se subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj shume. Komisioni e ka pyetur subjektin lidhur me burimin e krijimit të kësaj shume cash dhe, në përgjigjen e dhënë³⁰, subjekti ka deklaruar: “Si burim krijimi për gjendjen cash në banesë të deklaruar prej meje kanë shërbyer kursimet familjare të përftuara nga të ardhurat nga pagat ndër vite të miat dhe të bashkëshortit tim, E.T”.

19.3 Lidhur me kursimet cash, subjekti ka kryer deklaram në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013 me përshkrimin “Gjendje likuiditeti cash në shtëpi 200.000 lekë, në datën 31.12.2013” dhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014 me përshkrimin “Gjendje likuiditeti cash në shtëpi, 150.000 lekë nga të ardhurat nga punësimi”.

19.4 Komisioni kreu analizën financiare për vitin 2013, atëherë kur datojnë kursimet cash për herë të parë në shumën 200.000 lekë, pasi më vonë, konkretisht në deklaratën Vetting, rezulton se këto kursime janë deklaruar të pakësuara (150.000 lekë). Nga përlllogaritjet financiare të kryera nga Njësia e Shërbimit Ligjor, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të kursejë shumën 200.000 lekë në vitin 2013, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

Detyrime financiare

20. Kredi për shtëpi pranë Bankës Kombëtare Tregtare, në shumën 3.801.814 lekë, vërtetuar kjo me kontratën e kredisë dhe vërtetimit lëshuar nga BKT-ja. Shuma e shlyer deri në datën 21.10.2016 është 313.656,63 lekë. Shuma e mbetur pa shlyer 3.488.158 lekë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³¹.

20.1 ILDKPKI-ja në raportin e tij është shprehur: “Ndryshimi midis gjendjes së detyrimit të deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka³² ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme dhe, konkretisht, deklarimi i përket datës 21.10.2016, ndërsa konfirmimi i bankës i përket datës 28.1.2017”.

20.2 Komisioni këtë kredi, marrjen dhe qëllimin e saj, e ka trajtuar më sipër në këto rezultate.

20.3 Lidhur me detyrimin e mbetur pa shlyer, rezulton ai se deri më 27.1.2017 është në shumën 3.459.821,94 lekë.

20.4 Konfirmohet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga BKT.

³⁰ Me pyetësin nr. 3, datë 6.6.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

³¹ Kontratë kredie bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.8.2012, me palë kredidhënëse BKT e kredimarrëse Alma Troshani e dorëzuanës E.T, për shumën e marrë 3.801.814 lekë, me afat 25 vjet. Kredia është siguruar me bllokimin e apartamentit me sip. 54.45 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, S, Tiranë. Vërtetimi nr. *** prot., datë 21.10.2016, lëshuar nga BKT-ja për kredinë e marrë në shumën 3.801.814 lekë, nga e cila janë shlyer 313.656,63 lekë, si dhe aneksin e planit të pagesës. Aneksi nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

³² BKT-ja me shkresën nr. *** prot., datë 29.6.2017, konfirmon se shtetasja Alma Troshani ka kredi me balancë në datën 27.1.2017 në shumën 3.459.821 lekë, aneksi nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

21. Kredi konsumatore në shumën 200.000 lekë pranë Bankës Kombëtare Tregtare, vërtetuar kjo me kontratën e kredisë dhe vërtetimit lëshuar nga BKT, bashkëlidhur këtij deklarami. Shuma e shlyer deri në datën 21.10.2016 është 120.569 lekë, shuma e mbetur pa shlyer deri në këtë datë është 79.431 lekë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³³.

21.1 ILDKPKI-ja në raportin e tij është shprehur: “*Ndryshimi midis gjendjes së detyrimit të deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka³⁴ ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme dhe, konkretisht, deklarami i përket datës 21.10.2016, ndërsa konfirmimi i bankës i përket datës 28.1.2017*”.

21.2 Nga hetimi i Komisionit³⁵ rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka përfutur kredi konsumatore nëpërmjet kontratës bankare të lidhur në datën 7.11.2014 mes saj dhe BKT-së në shumën e deklaruar, 200.000 lekë.

21.3 Lidhur me detyrimin e mbetur pa shlyer, rezulton se deri më 27.1.2017 është në shumën 61.982,06 lekë.

21.4 Komisioni konstatoi se konfirmohet deklarami i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga BKT.

22. Overdraft në shumën 190.500 lekë, marrë pranë BKT-së. Deri në datën 21.10.2016, shuma e përdorur është 140.913 lekë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³⁶.

22.1 ILDKPKI-ja në raportin e tij është shprehur: “*Ndryshimi midis gjendjes së detyrimit të deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka³⁷ ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme dhe, konkretisht, deklarami i përket datës 21.10.2016, ndërsa konfirmimi i bankës i përket datës 28.1.2017*”.

22.2 BKT-ja³⁸ informon se subjekti i rivlerësimit ka llogari *overdraft*-i me limit 190.500 lekë, me datë aprovimi 20.8.2014.

22.3 Lidhur me gjendjen e llogarisë në datën 27.1.2017 është në vlerën -190.277,08 lekë.

22.4 Komisioni konstatoi se konfirmohet deklarami i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga BKT-ja.

Deklarimi i pasurive të bashkëshortit të subjektit, z. E.T

23. Bashkëshorti i subjektit, z. E.T, ka deklaruar: “*Pasuri që rrjedh nga trashëgimia në ¼ pjesë takuese, për pasurinë në përdorim nga mamaja ime, ndodhur aktualisht në proces legalizimi pranë ALUIZNI-t Shkodër, sipas vetëdeklarimit nr. *** prot., me datë 18.9.2005 (që rrjedh nga babai im i ndjerë, H.T), në objekt social - ekonomik (në bashkëpronësi të Y.T, L.T (mamaja), A.T, S.T, M.T, G.T, F.T, F.T dhe*

³³ Kontratë kredie bankare e lidhur në datën 7.11.2014, me palë kredidhënëse BKT, e kredimarrëse shtetasen Alma Troshani, për shumën 200.000 lekë, me afat 36 muaj. Vërtetimi nr. *** prot., datë 21.10.2016, lëshuar nga BKT, për kredinë e marrë në shumën 200.000 lekë, nga e cila është shlyer 120.569,92 lekë e aneksi i planit të pagesës. Aneks ***, administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁴ BKT-ja me shkresën nr. *** prot., datë 29.6.2017, konfirmon se Alma Troshani ka kredi me balancë në datën 27.1.2017, në shumën 61.982 lekë, aneksi nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 9.8.2021, nga BKT-ja.

³⁶ Vërtetimi nr. *** prot., datë 21.10.2016, lëshuar nga BKT-ja për *overdraft*-in e marrë në shumën 190.500 lekë, nga i cili deri ditën e sotme ka përdorur 140.913,32 lekë. Nxjerrje llogarie e BKT-së e datës 16.1.2017, për periudhën 1.1.2014 – 16.1.2017, me balancë - 132.040 lekë (aneksi nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së).

³⁷ BKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 29.6.2017, konfirmon se Alma Troshani ka llogari me balancë debitore - 190.277 lekë për shkak të *overdraft*-it të marrë, balanca në datën 27.1.2017 është 190.277 lekë (aneksi nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së).

³⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 9.8.2021, nga BKT-ja.

L.T), me sipërfaqe ndërtimi 180m², viti ndërtimi 1996. Numër katesh ***, me adresë në rr. “****” z. k. nr. ***, Njësia Administrative Nr. ***, Shkodër. Nga këto babai im ka pasur në përdorim një dyqan kati i parë me sipërfaqe 34 m², shtëpi banimi kati i tretë me sipërfaqe 180 m² dhe kati i pestë i papërfunduar, pjesëtarëve të sipërcituar. Sipas çmimeve të referencës sipas ZVRPP-së Shkodër, pjesa në përqindje ¼ pjesë takuese e H.T (të ndjerit babait tim). Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³⁹”.

23.1 ILDKPKI-ja në raportin e tij është shprehur: “Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar. ZVRPP Shkodër dhe ALUIZNI nuk e konfirmojnë këtë pasuri, pasi është në proces legalizimi sipas vetëdeklarimit të bërë nga shtetasi H.A.T, babai i bashkëshortit të subjektit”.

Hetimi i Komisionit

23.2 Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga bashkëshorti i subjektit, në deklaratën e pasurisë Vetting të subjektit të rivlerësimit. Në rubrikën përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “Pasuri që rrjedh nga trashëgimia në pjesë takuese 1/4 pjesë për pasurinë në përdorim nga mamaja ime, ndodhur aktualisht në proces legalizimi pranë ALUIZNI-t, Shkodër, sipas vetëdeklarimit nr. *** prot., me datë 18.9.2005 (që rrjedh nga babai im i ndjerë H.T), në objektin social ekonomik në bashkëpronësi (me 9 persona të tjerë të familjes Troshani), me sipërfaqe ndërtimi 180 m², viti i ndërtimit 1996, ndërtesë me *** kate, ndodhur në rr. “****”, z. k. nr. ***, Njësia Administrative Nr. ***, Shkodër. Nga kjo pasuri babai im ka pasur në përdorim një dyqan kati i parë me sipërfaqe 34 m², shtëpi banimi kati i tretë me sipërfaqe 180 m² dhe kati i pestë i papërfunduar, pjesët e tjera janë të pjesëtarëve bashkëpronarë”.

23.3 ZQRPP-ja⁴⁰ ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Shkodër⁴¹, ku konfirmohet se shtetasit Alma S. Troshani dhe E H. Troshani nuk kanë pasuri të regjistruar në emër të tyre.

23.4 ALUIZNI⁴² konfirmon se shtetasit Alma Troshani, E.T, E.T dhe A.T nuk figurojnë si subjekte aplikues për vetëdeklarimin e ndonjë objekti informal, në funksion të përfshirjes në procesin e legalizimeve.

23.5 Nga hetimi i Komisionit për këtë pronë, nga dokumentacioni i depozituar rezultoi se bashkëshorti i subjektit ka fituar të drejtën mbi këtë pronë nga babai i tij H.T. Në Dëshminë e Trashëgimisë⁴³ rezulton se shtetasi H.T ka vdekur në vitin 2015 dhe më tej, bashkëshortja e tij ka kërkuar çeljen e trashëgimisë për këtë pasuri. Trashëgimtarët e të ndjerit H.T, bashkëshortja L dhe tre fëmijët R, DH dhe E.T kanë përfituar ¼ pjesë të pasurisë trashëgimore.

23.6 Në vërtetimin e lëshuar nga ALUIZNI⁴⁴, Drejtoria Shkodër “Mbi statusin e përfshirjes së objektit të ndërtuar pa leje në proces legalizimi”, rezulton se shtetasi H.A.T ka dorëzuar pranë ALUIZNI-t Shkodër formularin e vetëdeklarimit⁴⁵ për objektin social-ekonomik 5 kate, sipërfaqe ndërtimi 180 m², viti ndërtimi 1996. Për këtë pasuri në proces legalizimi është kryer dhe aktekspertiza në datën 20.9.2016,

³⁹ Dëshmi trashëgimie ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.9.2016, nga e cila shtetasi E.T ka përfituar si trashëgimtar ¼ pjesë pas vdekjes së babait H.T. Vërtetim nr. *** prot., datë 2.11.2015, lëshuar nga ALUIZNI, Drejtoria Shkodër “Mbi statusin e përfshirjes së objektit të ndërtuar pa leje në proces legalizimi”, ku rezulton se shtetasja L.Q.T, trashëgimtare ligjore e bashkëshortit H.A.T, i cili ka dorëzuar pranë ALUIZNI-t Shkodër formularin për vetëdeklarim për legalizim objekti me të dhënat. Vetëdeklarim nr. *** prot., datë 18.9.2005, për objekt social-ekonomik *** kate, sipërfaqe ndërtimi 180 m², viti ndërtimi 1996. Aktekspertiza për objektin në fazë legalizimi, objekt shtëpi banimi dhe ambient shërbimi 4 e ½ kat, me 9 pronarë dhe porositëse shtetasen L.T, e datës 20.9.2016, si dhe fotot bashkëlidhur (aneksi nr. ***, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

⁴⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2017, administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴¹ Nr. *** prot., datë 18.7.2017, aneksi nr. ***, administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴² Me shkresën nr. *** prot., datë 14.7.2017, aneksi nr. ***, administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴³ Nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.9.2016, aneksi nr. ***, administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁴ Nr. *** prot., datë 2.11.2015, aneksi nr. ***, administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁵ Vetëdeklarimi nr. prot. ***, datë 18.3.2005, aneksi nr. ***, administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

për të ditur shkallën e qëndrueshmërisë konstruktive për objektin shtëpi banimi dhe ambient shërbimi 4 e ½ kate, me 9 bashkëpronarë dhe porositësen L.T.

23.7 Nga korrespondenca e Komisionit me Drejtorinë Vendore të ASHK-së⁴⁶ Shkodër, rezulton se shtetasi H.A.T, plus 9 shtetas të tjerë, është vetëdeklarues për ndërtim pa leje në Shkodër. Ky ndërtim është legalizuar dhe regjistruar në emër të anëtarëve dhe trashëgimtarëve të familjes Troshani në vitin 2022.

23.8 Drejtoria Vendore e ASHK-së Shkodër me informacionin e dërguar⁴⁷ ka bashkëngjitur edhe dosjen e legalizimit për pasurinë me nr. ***, e cila pasqyron procedurën e regjistrimit të kësaj pasurie, si dhe certifikatën e regjistrimit të saj, datë 5.8.2022, në emër të bashkëshortit të subjektit dhe pjesës së tij takuese 6/90.

23.9 Për sa më sipër, në bazë të dokumentacionit të depozituar, Komisioni konstaton se kjo pasuri është fituar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit me një nga mënyrat e parashikuara në ligj e konkretisht nëpërmjet dëshmisë së trashëgimisë ligjore, çelur në emër të babait të tij dhe si e tillë nuk diktohet ndonjë problematikë lidhur me ekzistencën dhe disponimin e ligjshëm të saj.

24. Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: *“1/19 pjesë takuese e sipërfaqes së tokës së kthyer me vendim të KKKPronave nr. ***, datë 30.4.1996, me sipërfaqe 346 m², kthyer në favor të kushërinjve të tij Troshani dhe babait H.T (sipërfaqe mbi të cilën është kryer ndërtimi i sipërcituar). Kjo sipërfaqe toke është regjistruar në ZVRPP-në Shkodër në emër të 19 anëtarëve të familjes së trungut Troshani, ndër to dhe babai im, i cili rezulton të jetë i 12-ti në listën e pronarëve, vërtetuar kjo me kopje të vendimit të KKKPronave dhe certifikatën e pronësisë, lëshuar nga ZVRPP Shkodër, e datës 20.6.2008, bashkëlidhur këtij deklarami. Vlera, sipas çmimeve të referencës sipas ZVRPP Shkodër. Pjesa në %, ¼ pjesë takuese e H.T (e të ndjerit babait tim). Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁴⁸”.*

24.1 ILDKPKI-ja në raportin e tij është shprehur: *“ZVRPP Shkodër nuk konfirmon pasuri të regjistruar në emër të E.T. Sipas dokumentacionit të paraqitur, pasuria është e regjistruar në emër të familjes Troshani”.*

Hetimi i Komisionit

24.2 Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga bashkëshorti i subjektit në deklaratën e pasurisë Vetting të subjektit të rivlerësimit. Në rubrikën përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: *“1/19 pjesë takuese të sipërfaqes së tokës së kthyer me vendim të KKKPronave nr. ***, datë 30.4.1996, me sipërfaqe 346 m², e kthyer në favor të kushërinjve të mi Troshani dhe babait tim H.T (sipërfaqe mbi të cilën është kryer ndërtimi i sipërcituar). Kjo sipërfaqe toke është regjistruar në ZVRPP-në Shkodër në emër të 19 anëtarëve të familjes së trungut Troshani, ndër to dhe babait im, i cili rezulton të jetë i 12-ti në listën e pronarëve, vërtetuar kjo me kopje të vendimit të KKKPronave dhe*

⁴⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 19.8.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴⁷ Me shkresën e ASHK-së Drejtoria Vendore Shkodër nr. *** prot., datë 19.10.2023, administruar e gjithë praktika në dosjen e Komisionit.

⁴⁸ Certifikatë pronësie e pasurisë truall me sipërfaqe 346 m², nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, lagjja “****”, datë lëshimi 20.6.2008, e ZVRPP-së Shkodër dhe harta treguese e regjistrimit, ku shtetasi H.T figuron si bashkëpronar i regjistruar në bazë të vendimit nr. regj. them. ***, datë 10.12.2012, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Vendimi nr. ***, datë 30.4.1996, i Komisionit të Kthimit e të Kompensimit të Pronave, Shkodër, për njohjen e pronësisë të truallit, me sipërfaqe 346 m², në favor të familjes Troshani. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nr. ***, datë 10.12.2012 “Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerët A.T dhe M.T”, kërkues H.A.T, e datëlindjes 27.9.1944 (aneks nr. ***, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

certifikatën e pronësisë lëshuar nga ZVRPP Shkodër e datës 20.6.2008, bashkëlidhur këtij deklarami. Vlera e çmimit të referencës, sipas ZVRPP Shkodër. Pjesa në %, ¼ pjesë takuese e H.T (të ndjerit babait tim)”.’

24.3 Nga hetimi i Komisionit për këtë pronë, nga dokumentacioni i depozituar rezultoi se bashkëshorti i subjektit ka fituar të drejtën mbi këtë pronë - truallin, ku është ngritur ndërtesa e përfituar nga procesi i legalizimit, trajtuar më lart, nga babai i tij H.T. Me vendimin⁴⁹ e Komisionit të Kthimit e të Kompensimit të Pronave, Shkodër, është bërë kthimi i pronësisë të truallit me sipërfaqe 346 m², në favor të familjes Troshani. Rezulton se pasuria e ka origjinën prej vitit 1941.

24.4 Në certifikatën e pronësisë⁵⁰, lëshuar nga ZVRPP Shkodër, datë 20.6.2008, konfirmohet pasuria truall me nr. ***, me sipërfaqe 346 m², në emër të 19 bashkëpronarëve, ku përfshihet edhe shtetasi H.T. Regjistrimi është bërë sipas vendimit gjyqësor nr. ***, datë 10.12.2012⁵¹, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerët A.T dhe M.T në emër të trashëgimtarëve M, M, S, S dhe H.T, të cilët kanë përfituar 1/5 pjesë të pasurisë trashëgimore.

24.5 Më tej, referuar certifikatës së ZVRPP-së datë 16.4.2018, kjo pasuri konfirmohet⁵² në emër të të gjithë bashkëpronarëve, përfshirë këtu edhe bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, me pjesë takuese 45/5400. Regjistrimi i saj është bërë bazuar në dëshminë e trashëgimisë⁵³, ku rezulton se shtetasi H.T ka vdekur në vitin 2015 dhe se trashëgimtarë të tij janë bashkëshortja L dhe tre fëmijët R, DH dhe E.T, të cilët kanë përfituar ¼ pjesë të pasurisë trashëgimore, duke mbartur kështu të drejtat e detyrimet që rrjedhin prej saj, aktit të dëshmisë.

24.6 Për sa më sipër, në bazë të dokumentacionit të depozituar, Komisioni konstaton se kjo pasuri është fituar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit me një nga mënyrat e parashikuara në ligj e konkretisht nëpërmjet dëshmisë së trashëgimisë ligjore çelur në emër të babait të tij dhe, si e tillë, nuk diktohet ndonjë problematikë lidhur me ekzistencën dhe disponimin e ligjshëm të saj.

Detyrime financiare – E.T (bashkëshorti)

25. Kredi për shtëpi pranë Bankës Kombëtare Tregtare në shumën 3.801.814 lekë, vërtetuar kjo me kontratën e kredisë dhe vërtetimit lëshuar nga BKT-ja. Shuma e shlyer deri në datën 21.10.2016 është 313.656,63 lekë. Shuma e mbetur pa shlyer 3.488.158 lekë. Bashkëlidhur deklaratës, subjekti ka depozituar disa dokumente⁵⁴.

25.1 Kjo kredi dhe detyrimi i mbetur është trajtuar më sipër në këtë vendim, tek deklarami i subjektit të rivlerësimit, ku nuk janë konstatuar problematika.

26. Komisioni kreu analizën financiare të detajuar nga viti 2015, vit i fillimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit dhe i rezultoi se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi financiare për vitin 2015 në shumën 442.465 lekë dhe në shumën 352.094 lekë për vitin 2016, për të përballuar shpenzimet familjare, duke i kaluar barrën e provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

⁴⁹ Nr. ***, datë 30.4.1996, e Komisionit të Kthimit e të Kompensimit të Pronave, Shkodër, për njohjen e pronësisë të truallit, me sipërfaqe 346 m², në favor të familjes Troshani, aneksi nr. ***, administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁰ Përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 19.10.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁵¹ Të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, aneksi nr. ***, administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵² Me shkresën nr. *** prot., datë 2.10.2023, administruar në dosjen e Komisionit së bashku me të gjithë praktikën përkatëse.

⁵³ Nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.9.2016, aneksi nr. ***, administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁴ Kontratë kredie bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.8.2012, me palë kredidhënës BKT e kredimarrës shtetasen Alma Troshani, e dorëzuanës E.T, për shumën e marrë 3.801.814 lekë, me afat 25 vjet. Vërtetimi nr. *** prot., datë 21.10.2016, lëshuar nga BKT, për kredinë e marrë në shumën 3.801.814 lekë, nga e cila ka shlyer 313.656,63 lekë, si dhe aneksin e planit të pagesës, aneksi nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

26.1 Lidhur me konstatimet e Komisionit, në qëndrimin e saj subjekti ka kontestuar përlllogaritjet e Komisionit lidhur me vlerën e shpenzimeve të jetesës sipas ILDKPKI-së për të dyja vitet, duke kërkuar që shpenzimet e jetesës për fëmijë të përlllogariten në masën 0.3 e një të rrituri, kjo nisur nga fakti se dy fëmijët e saj në vitin 2015 ishin 7 vjeç, ndërsa në vitin 2016 8 vjeç, ku sipas subjektit fëmijët kurrsesi nuk mund të shpenzojnë sa një i rritur, bazuar kjo në analizën dhe arsyetimin e parashtruar prej saj.

26.2 Subjekti ka kundërshtuar edhe përlllogaritjen e shpenzimeve të TIMS për vitin 2015 dhe 2016, pasi sipas saj për çdo udhëtim të kryer nga ajo dhe familjarët në këtë periudhë nuk janë kryer shpenzime për qëndrimin në Greqi apo Francë (lidhur me këto udhëtimet), përveç vlerës së biletës, pasi ka/kanë qëndruar në Greqi tek daja, z. G.K, i cili e ka konfirmuar këtë me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.7.2021, dhe tek vëllai, fakt të cilin ai e ka konfirmuar me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.8.2021.

26.3 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, si dhe në prapësime, në analizë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të rezultuara gjatë hetimit administrativ, arsyeton si vijon:

26.4 Lidhur me pretendimin e subjektit për përlllogaritje më të ulëta të shpenzimeve të jetesës për fëmijët, trupi gjykues rikonfirmon qëndrimin e tij, ku përlllogaritja e tyre i referohet aplikimit të standardit të vendosur sipas jurisprudencës të procesit të rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

26.5 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për ripërlllogaritjet e shpenzimeve TIMS, Njësia e Shërbimit Ligjor i ka përlllogaritur kostot e qëndrimit në vlerën 5 euro/dita kur qëndrimi ka qenë tek të afërmit dhe është provuar me dokumentacion mbështetës. Në këtë drejtim, trupi gjykues konstaton se për udhëtimin e kryer në vitin 2015, në Itali, ku subjekti ka shpjeguar dhe dokumentuar që qëndrimi ka qenë tek të afërmit, është rillogaritur kosto qëndrimi në vlerën 5 euro/dita, vlerësim ky sipas standardit të vendosur në jurisprudencën e Kolegjit, në vendimin nr. 11, datë 22.5.2019. Si rrjedhojë e marrjes në konsideratë të pretendimit të subjektit për këtë udhëtim, trupi gjykues konstaton se balanca negative në shumën 442.465 lekë për vitin 2015, shkon në vlerën 392.911 lekë.

26.6 Në përfundim të sa u parashtrua dhe u analizua më sipër, trupi gjykues pas rivlerësimit të zërave të analizës financiare në raport me pretendimet e subjektit, rikonstaton se subjekti gjendet në pamjaftueshmëri financiare në shumën totale prej 759.261 lekësh, respektivisht në vlerën 14.256 lekë për vitin 2012, vlerën 392.911 lekë për vitin 2015 dhe vlerën 352.904 lekë për vitin 2016, e cila është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes të procesit të rivlerësimit për këtë subjekt.

KONSTATIME TË TJERA

27. Gjatë hetimit rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte kryer disa transaksione, më konkretisht:

27.1 Kishte depozituar në Intesa Sanpaolo Bank, në datën 27.6.2006, shumën 14.000 euro dhe e kishte tërhequr atë në datën 26.7.2006.

27.2 Në llogarinë e saj bankare në ProCredit Bank ishte transferuar në datën 30.8.2006 shuma 25.050 euro nga SH.N me përshkrimin “Për dasmën” dhe në datën 31.8.2006 shuma 25.000 euro ishte transferuar me përshkrimin “Hua për përfituesin për blerje makine”.

27.3 Komisioni i kërkoi⁵⁵ shpjegime për këto transaksione dhe subjekti ka sqaruar: “Unë në atë periudhë (qershor 2006) kam aplikuar në Ambasadën Kanadeze (me seli në Romë, duke qenë se në Shqipëri kishte vetëm një zyrë konsullore) për të fituar të drejtën e rezidencës permanente (lejes së përhershme të qëndrimit) në Kanada, nëpërmjet një programi emigrimi që në atë kohë titullohej “S W”, duke dorëzuar dokumentacionin përkatës, si dhe duke paguar tarifën përkatëse të aplikimit (fee), të aplikimit për mua

⁵⁵ Pyetësor nr. 4, datë 28.6.2024.

si aplikante dhe bashkëshortit tim, si dhe ka qenë kusht që në llogarinë bankare time, në momentin e parë të verifikimit të dokumentacionit nga ana e tyre, duhej të ishte shuma prej 14.000 euro, si garanci për mundësi adaptimi në shtetin kanadez (shumë kjo e cila është depozituar prej meje në datën 27.6.2006). Kjo shumë është lënë e depozituar në bankë deri në datën 26.7.2006, datë në të cilën është tërhequr prej meje. Më pas, për llogari të këtij aplikimi janë paguar prej meje edhe shumat për secilin prej fëmijëve (A.T visa fee 95 euro dhe E.T visa fee 95 euro, depozitime këto të kryera prej meje për llogari të Ambasadës Kanadeze pas lindjes së fëmijëve). Në përgjigje të këtij aplikimi me kthim përgjigjen e datës 14.11.2008 të Ambasadës Kanadeze më është refuzuar kërkesa përfundimisht, pasi nuk plotësoja të gjitha kriteret.

Lidhur me burimin e krijimit të kësaj shume (14.000 euro), deklaroj se këto nuk janë para që unë dhe bashkëshorti im kemi disponuar dhe nuk kanë qenë tonat, por më janë mundësuar nga një mikeshë imja SH.N (me të cilën unë dhe im shoq kemi miqësi familjare). Në datën 27.6.2006, shtetasja SH.N ka tërhequr nga llogaria e saj bankare pranë Bankës Amerikane shumën 14.000 euro, shumë të cilën ma ka dhënë dhe unë e kam depozituar në llogarinë time, si garanci për shkak të aplikimit të mësipërm pranë Ambasadës Kanadeze dhe, këtë shumë, pasi e kam tërhequr nga llogaria ime në datën 26.7.2006, ia kam kthyer shtetasve SH.N, e cila po atë ditë e ka depozituar me ca kursime të saja të vogla (sikurse ka deklaruar në deklaratën noteriale, që po ju depozitoj me këtë pyetësor) në llogarinë e saj bankare pranë Bankës Amerikane, duke depozituar përkatësisht në llogarinë e saj në euro pranë Bankës Amerikane shumën 15.380 euro”.

Bashkëlidhur gjeni:

- Mandat postar imi drejtuar Ambasadës Kanadeze;
- Dy mandatarkëtime datë 26.5.2008, që provojnë shumën e kaluar për llogari të Ambasadës Kanadeze nga ana ime në emër të fëmijëve të mi;
- Statement i llogarisë bankare të shtetasve SH.N për datën 27.6.2006 dhe 26.7.2006, i nxjerrë nga Intesa Sanpaolo Bank, ku figurojnë transaksionet e saj bankare të këtyre dy datave;
- Deklaratë noteriale e shtetasve SH.N, G.N dhe Alma Troshani nr. *** rep., nr.*** kol., datë 5.7.2024.

Ndërsa lidhur me transaksionet bankare të kryera në llogarinë time bankare në ProCredit Bank, në datën 30.8.2006 dhe 31.8.2006, ju sqaroj se, sikurse ju ka rezultuar nga hetimi i kryer prej jush, në llogarinë time bankare në ProCredit Bank, në datën 30.8.2006 është transferuar shuma 25.050 euro nga shtetasja SH.N, shumë kjo e cila në datën 31.8.2006 është transferuar nga ana ime në llogarinë e bashkëshortit të shtetasve SH.N, z. G.N, i cili jetonte në Kanada me fëmijët e tyre, pasi kishin fituar të drejtën e rezidencës permanente atje dhe pastaj shtetësinë kanadeze, ndërsa znj. N, për shkak të aktivitetit tregtar që ushtronte në Shqipëri, pavarësisht faktit se kishte fituar të drejtën e qëndrimit permanent në Kanada, jetonte pjesërisht në Kanada dhe pjesërisht në Shqipëri.

Më lejoni të sqaroj disa rrethana që kanë lidhje me këto transaksione. Sikurse rezulton nga statement-i i bankar i llogarisë së shtetasve SH.N, të cilin po jua vendos në dispozicion, rezulton se në datën 30.8.2006 znj. N ka depozituar në llogarinë time shumën prej 25.050 euro, me përshkrimin “Për dasmë”. Po në këtë datë ajo ka transferuar shumën prej 25.000 eurosh në llogari të bashkëshortit të saj, z. G.N, me përshkrimin “Shlyerje borxhi personit përfitues për blerje”, sikurse rezulton tarifa e transferimit ndërkombëtar të kryer nga ana e bankës, ka qenë 50 euro. Në momentin e kryerjes së këtyre transaksioneve, ajo nuk i ka kushtuar rëndësi përshkrimit të transaksionit të kryer nga punonjësja, pasi qëllimi i saj ka qenë transferimi për llogari të bashkëshortit të saj i shumës prej 50.000 eurosh, me sa më pak tarifa bankare të mundshme dhe nga ana e punonjësës së bankës i është sugjeruar ta fraksionojë transaksionin që të mos paguante një tarifë të lartë transferte bankare. Sikurse vërehet nga statement-i

i llogarisë sime bankare në euro pranë ProCredit Bank, po atë ditë, pra në datën 30.8.2006, është hapur dhe llogaria ime, ku më pas nga ana e znj. N më është kaluar shuma prej 25.050 euro, me qëllim për t'i kaluar bashkëshortit të saj shumën prej 25.000 eurosh. Me të marrë informacionin nga bashkëshorti i saj që i kishte mbërritur shuma prej 25.000 eurosh të dërguara prej saj, të nesërmen në datën 31.8.2006 jam paraqitur pranë Bankës ProCredit së bashku me znj. N dhe i kam kaluar nga llogaria ime bankare në llogarinë e bashkëshortit të saj G.N shumën prej 25.000 eurosh, me përshkrimin që ju citoni, pa i vënë rëndësi përshkrimit, kjo nisur edhe nga fakti se qëllimi, destinacioni dhe përfituesi i vetëm i këtij transaksioni ishte familja N (bashkëshorti i znj. N, z. G). Sikurse theksova dhe më sipër, me këtë familje unë dhe im shoq kemi miqësi familjare, pasi familja e G me familjen e babait tim kishin pasur një miqësi që para viteve '90, miqësi e cila ishte ruajtur dhe kultivuar ndër vite.

Në momentin që nga ana juaj më është dërguar ky pyetësor, unë dhe znj. N jemi paraqitur pranë ProCredit Bank për të tërhequr statement, të cilin po jua vendos në dispozicion dhe mandatin përkatës të secilit arkëtim të saj in të datës 30.8.2006 dhe timin, datë 31.8.2006, ku kemi paraqitur kërkesë për të tërhequr mandatarkëtimet, me qëllim për të sqaruar çdo paqartësi që mund t'ju ketë rezultuar nga hetimi dhe për t'ju saktësuar ju se përfituesi ishte bashkëshorti i saj, z. G.N, pra familja N, por nga ana e bankës kemi marrë përgjigje se mandatarkëtimet ruhen për 10 vjet, duke na vënë në dispozicion vetëm statement-in bankar të llogarisë sime në euro e të llogarisë së shtetasve SH.N dhe vërtetim bankar, që vërteton se transferta e datës 31.8.2006 nga llogaria ime ka qenë në drejtim të përfituesit G.N. Subjekti ka depozituar dokumentacion:

- Statement bankar i nxjerrë nga ProCredit Bank, datë 1.7.2024, për lëvizjet e llogarisë sime në euro pranë kësaj banke nga data e hapjes së saj deri në datën 29.5.2008, data e mbylljes, nga ku rezulton se i vetmi transaksion i kryer është ai për llogari të familjes N, që ju keni konstatuar.
- Statement bankar i nxjerrë nga ProCredit Bank, datë 1.7.2024, për lëvizjet e llogarisë së shtetasve SH.N në euro pranë kësaj banke, ku pasqyrohen lëvizjet e saj bankare të datës 30.8.2006.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 5.7.2024 i lëshuar nga ProCredit Bank, ku përshkruhet transferta nga llogaria ime e datës 31.8.2006 në drejtim të përfituesit G.N.
- Deklaratë noteriale e shtetasve SH.N, G.N dhe Alma Troshani nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.7.2024.

27.4 Komisioni, pavarësisht konstatimit paraprak se në vitin 2006 subjekti nuk ka qenë në detyrë, hetoi për të verifikuar mbi lidhje të mundshme të subjektit me këto transaksione, dhe nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në raport edhe me shpjegimet e subjektit, konstatoi se veprimet janë kryer: (i) si garanci administrative për aplikim për marrjen e vizës kanadeze; (ii) për llogari të mikeshës së saj, ku subjekti ka pasur vetëm rol ndërmjetësi. Gjithashtu rezultoi se këto shuma nuk janë përdorur dhe nuk kanë shërbyer si burim për asnjë pasuri në adresë të subjektit, dhe në këto kushte nuk u evidentuan rrethana të tilla që të afektojnë procesin e rivlerësimit të subjektit.

Konkluzion përfundimtar mbi pasurinë

27.5 Në përfundim, trupi gjykues lidhur me pamjaftueshmërinë financiare në shumën 759.261 lekë, vlerëson se kjo balancë negative, e shpërndarë ndër vite, bazuar në parimin e proporcionalitetit sipas jurisprudencës së Kpa-së⁵⁶, nuk çënon nivelin e besueshmërisë në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit në kuptim të përcaktimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLI I FIGURËS

⁵⁶ Nr. *** datë 02.02.2023, Nr. *** datë 16.02.2023.

28. AKSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, të ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës, nr. *** prot., datë 27.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 9.4.2024 dhe nr. ***, datë 23.5.2024, me konstatimin për përshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës së subjektit Alma Troshani.

Hetimi i Komisionit

28.1 Komisioni në vijim, si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

28.2 Më tej, pas kërkesës së Komisionit për përditësimin e informacioneve, AKSIK-ja⁵⁷ në informacionin e përcjellë nuk konfirmon të dhëna të përditësuara për përfshirje të subjektit të rivlerësimit në veprimtari të kundërligjshme.

28.3 Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit Alma Troshani arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka kryer deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

29. Hetimi i Komisionit lidhur me kriterin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit është bazuar në analizimin e:

- a. raportit⁵⁸ të hartuar nga KLGJ-ja për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- b. kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij);
- c. denoncimeve të paraqitura sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016⁵⁹.

29.1 Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- a. formularit të vetëdeklarimit;
- b. të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së;
- c. tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- d. 5 dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

⁵⁷ Me shkresën datë 8.5.2024.

⁵⁸ Raporti i KLGJ-së nr. *** prot., datë 10.2.2023.

⁵⁹ Ligji nr. 84/2016, neni 53: “Pjesëmarrja e publikut në denoncimin e fakteve 1. Çdo person që vjen në dijeni të fakteve ose rrethanave që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit, ka të drejtë të informojë drejtpërdrejt institucionet e rivlerësimit. Institucioni i rivlerësimit është i detyruar të kontrollojë nëse informacioni është dhënë nga një person i njohur ose anonim. 2... etj.”.

Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit

30. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, konstatohet si më poshtë:

a. Saktësia e formularit të vetëdeklarimit

Formulari paraqitet i plotë dhe i nënshkruar, pa kundërthënie dhe, sipas shtojcës që parashikon ligji, me përjashtim se në rubrikën “A” të formularit, nga subjekti në vend të numrit personal (ID) është deklaruar gabim numri i letërnjoftimit personal, por është saktësuar nga kopja e paraqitur e ID-së.

b. Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit

Sipas të dhënave të deklaruara në rubrikën “B” të formularit, për periudhën mars 2009 – qershor 2015 subjekti ka deklaruar se ka qenë e punësuar si avokate shteti në Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit. Në periudhën qershor 2015 – prill 2016, ajo ka deklaruar se ka qenë e punësuar si ndihmëse ligjore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe, nga muaji prill i vitit 2016 e në vazhdim, ajo ka deklaruar se ushtron detyrën e ndihmëses ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Gjithashtu ajo ka paraqitur si dokument titullin “Avokat Shteti”, të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, në datën 14.7.2010.

c. Detyrat e kryera 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore

Subjekti i rivlerësimit Alma Troshani ka deklaruar se tri vitet e fundit ka punuar në fushën e të drejtës administrative, në detyrën e ndihmëses ligjore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatën Administrative të Apelit. Konfirmohet nga urdhri nr. ***, datë 10.6.2015, i kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, se znj. Alma Troshani është caktuar të kryejë detyrën e ndihmëses ligjore pranë gjyqtarëve E.R e E.R. Gjithashtu, konfirmohet nga shkresa nr. *** prot., datë 14.4.2016, se kryetari i Gjykatës Administrative të Apelit ka urdhëruar që subjekti i rivlerësimit Alma Troshani të emërohet në detyrën e ndihmëses ligjore në Gjykatën Administrative të Apelit. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në formular specializime në fushën e të drejtës⁶⁰.

Subjekti i rivlerësimit në funksionin e ndihmëses ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatën Administrative të Apelit ka deklaruar se:

- në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka përfunduar 189 çështje;
- në Gjykatën Administrative të Apelit ka përfunduar 413 çështje.

d. Trajnimet në 3 vitet e fundit

Subjekti i rivlerësimit Alma Troshani ka deklaruar se ka marrë pjesë në 4 trajnime në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës⁶¹, por vetëm tri prej këtyre aktiviteteve i përkasin periudhës së rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016.

⁶⁰ Master MND në Legjislacion dhe Institucionet Europiane, të mbrojtur në Universitetin e Tiranës, duke bashkëlidhur diplomën nr. ***, datë 22.2.2013; specializim 4-mujor pranë Shkollës së Magjistraturës, në bashkëpunim me AECId dhe Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit, duke bashkëlidhur certifikatën; Specializim 6-mujor pranë Njesisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, ku është certifikuar “Auditues i brendshëm në sektorin publik”. Për të gjitha këto subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur certifikatat.

⁶¹ “Ligji mbi shoqëritë tregtare”, i zhvilluar më 18 nëntor 2013; “Zhvillime të legjislacionit të prokurimeve publike dhe atij fiskal në këndvështrimin e gjykimeve administrative”, i zhvilluar më 28 tetor 2015; “Tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi mbi të ardhurat dhe taksimi ndërkombëtar në ndihmë të gjykimeve administrative”, i zhvilluar më 5-6 tetor 2016.

Gjithashtu, lidhur me trajnimet e tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës⁶², subjekti ka deklaruar në formular pjesëmarrjen e saj, si dhe ka bashkëlidhur certifikatat për pjesëmarrjen në këto trajnime, të lëshuara nga Shkolla e Magjistraturës. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe dokumente⁶³ të tjera.

Të dhëna nga burime arkivore të KLGJ-së

31. Subjekti i rivlerësimit Alma Troshani nuk ka të dhëna në burimet arkivore të KLGJ-së për periudhën e rivlerësimit, për shkak të detyrës si ndihmëse ligjore që ajo ka ushtruar në këtë periudhë, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatën Administrative të Apelit.

Analiza e gjetjeve

32. Analiza e gjetjeve u referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit; ii) dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (iii) 5 dokumenteve ligjore të vëzhguara të përzgjedhura me short.

32.1 Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Procesi i rivlerësimit kalimtar të ndihmësve ligjorë pranë gjykatave administrative parashikohet dhe rregullohet nga neni 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016⁶⁴ “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nga neni 165 i ligjit nr. 96/2016⁶⁵ “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Referuar parashikimeve ligjore e nënligjore në fuqi për kohën kur kryhet ky proces rivlerësimi profesional, për ndihmësit ligjorë, ndryshe nga magjistratët-gjyqtarë, nuk ka pasur të miratuar nga një organ kompetent një sistem vlerësimi profesional.

Për rrjedhojë, për ndihmësit ligjorë në gjykatat administrative nuk ka kritere matëse të punës, sikurse kanë ekzistuar për magjistratët-gjyqtarë, ndaj dhe vlerësimi i aftësive profesionale të tyre nuk ndjek detyrimisht të njëjtat rregulla si për magjistratët-gjyqtarë.

Në këto kushte, vlerësimi i aftësive profesionale të ndihmësve ligjorë pranë gjykatave administrative do të kryhet në përputhje me parashikimin e nenit 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 të sipërcituar, si dhe bazuar

⁶² “Zbatimi i Sistemit të Drejtësisë Administrative në Shqipëri”, organizuar nga ASPA dhe OSBE më 31 tetor 2014, bashkëlidhur certifikata; “Roli i Avokatit dhe asistencës për sa i përket kontratave ndërkombëtare”, organizuar nga EURALIUS më 29.6.2011, bashkëlidhur certifikata; “Q, A and E of L”, organizuar nga A. Institute në Hagë të Holandës më 7-16 prill 2014.

⁶³ Kopje e dëshmisë së gjuhës angleze me nr. *** regj., lëshuar nga Universiteti i Tiranës; fotokopje e listës së notave në sezonin e verës të vitit 1999 – 2000 në kursin e plotë; fotokopje e certifikatës së titullit “Avokat” me nr. ***, datë 11.5.2002; fotokopje e diplomës e titullit “Jurist” me nr. 207, lëshuar nga Universiteti “L.G” në Shkodër; fotokopje e certifikatës për përfundimin e kursit të kompjuterit; fotokopje e kartës së identitetit, ku konstatohet se të dhënat përputhen pjesërisht me ato të deklaruara prej saj në formular; fotokopje e dy certifikatave për pjesëmarrje në trajnime në Shkollën e Magjistraturës, në datat 10-11 tetor 2012 dhe 4-5 prill 2013, jashtë periudhës së rivlerësimit.

⁶⁴ Ligji nr. 84/2016, neni 42, pika 2 - “Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, i Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; b) rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës”.

⁶⁵ Ligji nr. 96/2016, neni 165, pika 1: “Këshilltari i gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësi ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe në gjykatat administrative, si dhe inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që nuk gëzon statusin e gjyqtarit ose prokurorit, janë subjekt i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

në përmbajtjen e nenit 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Referuar të dhënave mbi eksperiencën e saj, subjekti i rivlerësimit Alma Troshani ka një eksperiencë të mirë në fushën e drejtësisë.

32.2 Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit Alma Troshani rezulton se ka ushtruar detyrën e ndihmëses ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nga data e emërimit të saj 10.6.2015 e deri më 14.4.2016. Në funksionin e ndihmëses ligjore pranë kësaj gjykate, ajo ka deklaruar se në periudhën 10.6.2015 – 14.4.2016 i janë caktuar dhe ka përfunduar 189 çështje, të kërkuara nga gjyqtarët që ajo ka asistuar. Këto të dhëna statistikore janë të deklaruara nga vetë subjekti në formularin e vetëvlerësimit profesional.

Ndërsa, sipas informacionit zyrtar të paraqitur nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, për efekt të organizimit të përzgjedhjes së 5 dokumenteve me short, rezulton se për periudhën 10.6.2015 – 14.4.2016 subjekti i rivlerësimit ka asistuar gjyqtarët E.R dhe E.R. Rezultoi se gjyqtari E.R në atë periudhë ka shpallur 155 vendime, ndërsa gjyqtari E.R ka shpallur 467 vendime. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka ndihmuar gjyqtarët E.R e E.R në përpilimin dhe përgatitjen e 622 çështjeve gjyqësore.

Duhet evidentuar fakti se për subjektin e rivlerësimit nuk ka të dhëna direkte për ngarkesën dhe punën e saj, por të dhënat janë nxjerrë nga dosjet gjyqësore të dy gjyqtarëve, pranë të cilëve ajo është caktuar të asistojë.

Kuadri ligjor në fuqi për kohën kur kryhet ky vlerësim profesional, nuk përcakton standarde minimale pune për ndihmësin ligjor të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Nga të dhënat statistikore të deklaruara nga vetë ndihmësja ligjore Alma Troshani, por edhe ato të dhëna të përcjella nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë për efekt të shortit, mund të themi se subjekti i rivlerësimit ka përballuar një ngarkesë të lartë pune dhe ka përfunduar në kohë detyrat e ngarkuara nga gjyqtarët asistues. Subjekti i rivlerësimit ka asistuar në të njëjtën kohë dy gjyqtarë, ku secili prej tyre ka shpallur një numër të lartë vendimesh gjyqësore.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Detyrat e ndihmësit ligjor të gjykatave administrative janë parashikuar në nenin 6 të ligjit nr. 49/2012 dhe konkretisht në paragrafin 1 e 2 të tij, ku sanksionohet se:

“1. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe i Gjykatës Administrative të Apelit në veprimtarinë e tij ndihmohet nga ndihmësi ligjor.

2. Ndihmësi ligjor ndihmon dhe këshillon gjyqtarin lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor, si dhe përgatit projektakte procedurale të nevojshme për gjykimin. Me kërkesë të gjyqtarit, ndihmësi ligjor bën kërkime ligjore dhe përgatit opinione me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material që lidhen me çështjet në gjykim”.

Rezulton qartë nga përmbajtja e ligjit të sipërcituar se ndihmësi ligjor nuk kryen procedura gjyqësore. Ky kriter vlerësimi shërben dhe zbatohet vetëm për gjyqtarin, i cili ka të përcaktuara qartësisht në ligj detyrat e tij procedurale, duke filluar që nga marrja me short e çështjes e deri në përfundimin e saj me vendim përfundimtar.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Edhe ky kriter vlerësimi zbatohet vetëm për gjyqtarët. As në ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative” dhe në asnjë ligj apo akt nënligjor tjetër nuk parashikohet si detyrë për ndihmësin që të administrojë një dosje gjyqësore.

32.3 Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Ndihmësi ligjor për shkak të natyrës së punës nuk ka kontakte me palët ndërgjyqëse, pasi nuk merr pjesë në seancë gjyqësore.

Lidhur me etikën në punë të subjektit të rivlerësimit Alma Troshani, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ku ka ushtruar detyrën ndihmësja ligjore, ka pasqyruar në shkresën e saj nr. *** prot., datë 26.1.2023, se për subjektin e rivlerësimit Alma Troshani gjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezulton të ketë pasur asnjë masë disiplinore. Po kështu, edhe Gjykata Administrative e Apelit, ka pasqyruar në shkresën e saj nr. *** prot., datë 27.1.2023, se për subjektin e rivlerësimit Alma Troshani gjatë periudhës së rivlerësimit nuk ka të dhëna për shkelje disiplinore.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Alma Troshani dhe nga dokumentet ligjore të vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Ky element vlerësues është tipik për gjyqtarin, i cili ka detyrimin ligjor jo vetëm të jetë i paanshëm në një proces gjyqësor, por edhe të sillet si i tillë sipas parimit “Drejtësia jo vetëm duhet të jepet, por edhe të duket”.

Ndihmësi ligjor nuk ka kontakte me palët ndërgjyqëse, pasi nuk është pjesëmarrës në një proces gjyqësor dhe as subjekt procedural. Ndihmësi ligjor nuk është organ vendimmarrës, por këshillues dhe asistues i gjyqtarit. Në tri projektvendimet e përgatitura dhe të paraqitura nga ndihmësja ligjore Alma Troshani, nuk konstatohen elemente favorizuese apo njëanshmërie në raport me palët ndërgjyqëse pjesëmarrëse në ato procese gjyqësore që u përkasin projektvendimet.

32.4 Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Rezultoni se subjekti Alma Troshani ka nisur punë si ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me urdhrin nr. ***, datë 10.6.2015, të kryetarit të asaj gjykate.

Në të 8 dokumentet ligjore të analizuar nuk ka të dhëna për mënyrën e komunikimit të subjektit të rivlerësimit Alma Troshani me palët ndërgjyqëse, pasi për shkak të natyrës së punës nuk ka kontakt me ta, ndërsa gjuha e përdorur në aktet e përpiluara prej saj mund të vlerësohet si korrekte dhe normale.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore të paraqitura dhe në 5 çështjet e shortuara të vëzhguara, nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me gjyqtarët, me kolegët e tyre dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Ndërkohë, në asnjë prej dosjeve të vëzhguara dhe praktikave përkatëse nuk evidentohet problematikë në bashkëveprimin e saj me dy gjyqtarët, të cilët ka asistuar.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit Alma Troshani ka deklaruar se për periudhën mars 2009 – qershor 2015 subjekti ka qenë e punësuar si avokate shteti në Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit. Në periudhën qershor 2015 –prill 2016, ajo ka deklaruar se ka qenë e punësuar si ndihmëse ligjore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe, nga muaji prill i vitit 2016 e në vazhdim, ajo ka deklaruar se ushtron detyrën e ndihmëses ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Subjekti i rivlerësimit Alma Troshani ka deklaruar se ka marrë pjesë dhe është certifikuar në tri trajnime në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, që i përkasin periudhës së rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, me temë “Ligji mbi shoqëritë tregtare”, i zhvilluar më 18.11.2013; “Zhvillime të legjislacionit të prokurimeve publike dhe atij fiskal, në këndvështrimin e gjykimeve administrative”, i zhvilluar më 28.10.2015 dhe “Tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi mbi të ardhurat dhe taksimi ndërkombëtar në ndihmë të gjykimeve administrative”, i zhvilluar më 5-6 tetor 2016.

Lidhur me trajnimet e tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, subjekti ka deklaruar në formular pjesëmarrjen në tri trajnime, me temë “Zbatimi i sistemit të drejtësisë administrative në Shqipëri”, organizuar nga ASPA dhe OSBE më 31 tetor 2014; “Roli i avokatit dhe asistencës për sa i përket kontratave ndërkombëtare”, organizuar nga EURALIUS më 29 qershor 2011 dhe “Q A and E of L”, organizuar nga A. I në Hagë të Holandës më 7-16 prill 2014.

Ndihmësi ligjor është njësi ndihmëse, pjesë e organizimit të brendshëm të gjykatave administrative. Në nenin 6, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative përcaktohet se: *“Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit Administrativ, në veprimtarinë e tij ndihmohet nga ndihmësi ligjor”*.

Ndërsa në nenin 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, detajohen detyrat e ndihmëses ligjore, ku shprehimisht thuhet: *“Ndihmësi ligjor ndihmon dhe këshillon gjyqtarin lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor, si dhe përgatit projektakte procedurale të nevojshme për gjykimin. Me kërkesë të gjyqtarit, ndihmësi ligjor bën kërkime ligjore dhe përgatit opinione me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material që lidhen me çështjet në gjykim”*.

Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

33. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur 3 dokumente, draft-relacione për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, në Gjykatën Administrative të Apelit. Të tria dokumentet ligjore i përkasin vitit 2016.

Dokument 1. Draft-relacion për çështjen administrative nr. *** regj., datë 23.10.2014, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditëse L.D, kundër të paditurit Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, me objekt “Detyrimi i ZVRPP Tiranë të regjistrojë vendimin e gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. ***, datë 30.12.2005, të formës së prerë dhe të më pajisë me certifikatë pronësie”.

Subjekti i rivlerësimit Alma Troshani ka paraqitur draft-relacionin në formën e vendimit për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, i cili ka pjesën hyrëse që fillon me pasqyrimin e emrit të gjyqtarës kryesuese/relatore të trupit gjykues, numrin e regjistrimit të çështjes dhe datën e seancës. Më pas, relacioni përmban paraqitjen e palëve, objektin e padisë dhe bazën ligjore.

Më pas, në këtë dokument rezulton i pasqyruar dispozitivi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për rrëzimin e kërkesëpadisë së paditësit. Po ashtu, rezultojnë të pasqyruara shkaqet e parashtruara në ankimin e depozituar nga pala paditëse në Gjykatën Administrative të Apelit, të paraqitur ndaj vendimit të dhënë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, bazën ligjore përkatëse procedurale civile dhe dispozitën përkatëse të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative”, për ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë.

Draft-relacioni është i strukturuar në 2 nënpjesë të tjera: (i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohet në mënyrë të qartë ecuria e veprimeve të palëve ndërgjyqëse lidhur me kontratën e sipërmarrjes mbi një apartament, objekt i kësaj kontrate dhe regjistrimin e saj pranë palës së paditur; (ii) vendimi dhe arsyetimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku pasqyrohet se gjykata në analizë të pretendimeve të parashtruara në padi, provave shkresore të administruara dhe rrethanave të faktit e të ligjit, ka vlerësuar se padia është e pabazuar në ligj dhe në prova. Më tej, ndihmësja ligjore ka argumentuar se kërkimi i paditëses për detyrimin për regjistrim është gjykuar një herë nga gjykata me vendim të formës së prerë, ndaj, një kërkim i tillë përbën gjë të gjykuar sipas nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile.

Draft-relacioni rezulton të jetë një përshkrim i vendimmarrjes së Gjykatës së Shkallës Së Parë dhe parashtrimi të pretendimeve të ngritura në ankim nga pala paditëse. Pretendimet e paraqitura nga pala paditëse ankuese janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në mënyrë të saktë, por konstatohet se nuk ka mendim/sugjerim/rekomandim të vetë ndihmësit ligjor për zgjidhjen e çështjes, por vetëm referim tek arsyetimi i vendimit të shkallës së parë.

Paragrafët janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe të rregullt. Janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive dhe janë përdorur të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Në përmbajtje të draft-relacionit nuk është përdorur referencë në fund të faqeve, por përmban gjithsej 5 faqe, është konceptuar nga subjekti i rivlerësimit, përmban në fund firmën e saj, por nuk pasqyron datën e përpilimit.

Përmenden dhe analizohen në arsyetim norma të Kodit Civil, Kodit të Procedurës Civile, ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative...” dhe ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

Dokumenti 2. Draft-relacion për çështjen administrative me nr. *** regj., datë 6.11.2014, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditëse shoqëria “***” sh.p.k. kundër të paditurit Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, me objekt “Pavlefshmëri e titullit ekzekutiv, vendimi nr. ***, datë 5.8.2011, i të paditurit, marrjen e masës së sigurimit për pezullimin e ekzekutimit dhe veprimeve përmbartimore”.

Subjekti i rivlerësimit Alma Troshani ka paraqitur draft-relacionin në formën e vendimit për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, i cili ka pjesën hyrëse, që nis me pasqyrimin e emrit të gjyqtarës kryesuese/relatore të trupit gjykues, faktin se shqyrtohet në dhomë këshillimi, numrin e regjistrimit të çështjes dhe datën e seancës. Më pas, draft-relacioni përmban paraqitjen e palëve, objektin e padisë dhe bazën ligjore.

Më pas, në këtë dokument rezulton i pasqyruar dispozitivi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për pranimin e kërkesëpadisë së paditësit. Po ashtu, rezultojnë të pasqyruara shkaqet e parashtruara në ankimin e depozituar nga pala e paditur në Gjykatën e Apelit Durrës. Pasi ka pasqyruar vendimin për moskompetencën e Gjykatës së Apelit Durrës në gjykimin e kësaj çështjeje dhe dërgimin e akteve për kompetencë funksionale Gjykatës Administrative të Apelit, ndihmësja ligjore ka pasqyruar ankimin e palës së paditur dhe pretendimet ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë me paragrafë të veçantë. Me paragrafë më vete, të ndarë me hapësirë, është paraqitur kërkimi i palës së paditur, baza ligjore përkatëse procedurale civile dhe dispozita përkatëse e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative”, që ka kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe rrëzimin e kërkesëpadisë.

Draft-relacioni është i strukturuar në 2 nënpjesë të tjera: (i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohet në mënyrë të qartë ecuria e veprimeve të palëve ndërgjyqëse lidhur me gjobën e vendosur, si titull ekzekutiv për mungesën e dokumentacionit teknik të produkteve të betonit, veprime këto që përbëjnë kundërvajtje; (ii) vlerësimi dhe arsyetimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ku pasqyrohet se gjykata në analizë të pretendimeve të parashtruara në padi, provave shkresore të administruara dhe rrethanave të faktit e të ligjit, ka vlerësuar se vendimi për dënim me gjobë i palës së paditur është një akt administrativ i nxjerrë në referim të ligjit “Për inspektimin e ndërtimit”.

Por, ndihmësja ligjore ka argumentuar më pas se referuar provave shkresore të administruara në dosje rezulton se njoftimi për dënim me gjobë është kryer nëpërmjet inspektorëve të palës së paditur dhe jo nëpërmjet njoftimit zyrtar në adresën e deklaruar në regjistrin tregtar. Gjithashtu, ajo ka argumentuar se vendimi i dënimit me gjobë nuk është kthyer në titull ekzekutiv, pasi nuk ka kaluar afati 10-ditor për ankimin e tij në gjykatë. Përfundimisht, ndihmësja ligjore ka sugjeruar përfundimin se kërkesëpapia është e mbështetur në prova dhe në ligj dhe si e tillë duhet pranuar.

Draft-relacioni rezulton të jetë një përshkrim i vendimmarrjes së Gjykatës së Shkallës Së Parë dhe parashtrimi të pretendimeve të ngritura në ankim nga pala e paditur. Pretendimet e paraqitura nga pala e paditur ankuese janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në mënyrë të saktë, ku konstatohet edhe sugjerimi/rekomandimi për zgjidhjen e çështjes, pra jo referimi tek arsyetimi i vendimit të shkallës së parë.

Paragrafët janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe të rregullt. Janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive, por nuk janë përdorur të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Në përmbajtje të draft-relacionit nuk është përdorur referencë në fund të faqeve. Draft-relacioni përmban gjithsej 8 faqe, është konceptuar nga subjekti i rivlerësimit, përmban në fund firmën e saj, por nuk pasqyron datën e përpilimit.

Përmenden dhe analizohen në arsyetim norma të Kodit Civil, Kodit të Procedurës Civile, ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative...”, ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” etj.

Dokumenti 3. Draft-relacion për çështjen administrative me nr. *** regj., datë 6.7.2015, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditëse shoqëria “****” sh.p.k. kundër të paditurve Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë dhe Drejtoria e Apelit Tatimor, me objekt “Anulimi i pjesshëm i njoftimit të vlerësimit nr. ***, datë 26.11.2014, duke lënë në fuqi gjobën e kontabilitetit, etj”.

Subjekti i rivlerësimit Alma Troshani ka paraqitur draft-relacionin në formën e vendimit për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, i cili ka pjesën hyrëse, që fillon me pasqyrimin e gjyqtarës kryesuese/relatore të trupit gjykues, faktin se shqyrtohet në dhomë këshillimi, numrin e regjistrimit të çështjes dhe datën e seancës. Më pas, draft-relacioni përmban paraqitjen e palëve, objektin e padisë dhe bazën ligjore.

Më pas, draft-relacioni ka vazhduar me dispozitivin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për rrëzimin e kërkesëpadiisë. Është pasqyruar ankimi i palës paditëse, duke paraqitur pretendimet ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë me paragrafë të veçantë. Me paragrafë më vete është paraqitur kërkimi i palës paditëse, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pranimin e kërkesëpadiisë.

Draft-relacioni në formën e vendimit rezulton i strukturuar edhe në 2 nënpjesë të tjera: (i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohet në mënyrë të qartë ecuria e veprimeve të palëve ndërgjyqëse lidhur me kontrollin tatimor të ushtruar nga pala e paditur dhe njoftim vlerësimi objekt gjykimi i aplikuar; (ii) vlerësimi dhe arsyetimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku pasqyrohet se faturat janë dokumenti bazë për TVSH-në, pasi ato përcaktojnë detyrimin tatimor të furnizuesit dhe shumën e tatimit të zbritshëm që do t’i lejohet të kërkojë blerësi i regjistruar për TVSH-në.

Draft-relacioni është i strukturuar me nënpjesë të ndara, ku pasqyrohet në mënyrë të qartë mosmarrëveshja objekt gjykimi dhe arsyetimi i Gjykatës Administrative të Apelit se pala paditëse në dokumentacionin e paraqitur nuk provon se shërbimi i ka shërbyer aktivitetit të tatueshëm të shoqërisë, pasi nuk përbën dokumentacion të mirëfilltë justifikues.

Në përmbyllje të draft-relacionit është parashtruar nga ndihmësja ligjore në një paragraf më vete se Gjykata Administrative e Apelit ka çmuar se pretendimet e palës paditëse mbeten të paprovuara në

gjykim dhe se nuk u provua kryerja e ndonjë shkelje prej palës së paditur gjatë lëshimit të njoftim-vlerësimit për detyrimet tatimore.

Në një paragraf më vete ndihmësja ligjore ka dhënë mendimin konkret se padia e paraqitur nga pala paditëse duhet të rrëzohet si e pabazuar me prova e në ligj.

Draft-relacioni rezulton të jetë i plotë, me një përshkrim të vendimmarrjes së Gjykatës së Shkallës së Parë dhe parashtrimit të pretendimeve të ngritura në ankim nga pala paditëse. Arsyetimi se ku është mbështetur Gjykata e Shkallës së Parë në vendimmarrje, është paraqitur prej saj në mënyrë të zgjeruar dhe rezulton i qartë mendimi konkret i ndihmësit ligjor për zgjidhjen e çështjes.

Paragrafët janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe të rregullt, janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive, por nuk janë përdorur të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Në përmbajtje të relacionit nuk është përdorur referencë në fund të faqeve. Draft-relacioni përmban gjithsej 6 faqe, konceptuar nga subjekti i rivlerësimit dhe i nënshkruar në fund prej saj, por nuk pasqyrojnë datën e përpilimit.

Përmenden dhe analizohen në arsyetim norma të Kodit Civil, Kodit të Procedurës Civile, ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative”, ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, ligjit nr. 8438 i vitit 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, udhëzimi nr. 5 - datë 30.1.2006, udhëzimi nr. 17 - datë 13.5.2008 “Për TVSH-në” etj.

Hetimi i Komisionit për 3 dokumentet e përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit

33.1 Tri dokumentet⁶⁶ e përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit i përkasin periudhës kohore në të cilën subjekti ka qenë në funksionin e ndihmësit ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit me urdhrin nr. *** prot., datë 14.4.2016, është emëruar ndihmës ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, e cila informon⁶⁷ se subjekti i rivlerësimit është caktuar të kryejë detyrën e ndihmësit ligjor pranë gjyqtarës Bernina Kondi.

33.2 Tri dokumentet e përzgjedhura tregojnë se subjekti i rivlerësimit ka trajtuar mosmarrëveshje që lidhen me procedurën administrative në fushën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (dokumenti 1); mosmarrëveshje që lidhen me vlefshmërinë e titujve ekzekutive dhe veprimet përmbartimore (dokumenti 2); mosmarrëveshje që lidhen me procedurën administrative në fushën e tatimeve (dokumenti 3).

33.3 Tri dokumentet janë draft-relacione në formën e vendimit për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi. Fillimisht, subjekti përcakton se janë përgatitur për gjyqtaren relatores B.K, më pas ato përmbajnë paraqitjen e palëve, objektin e padisë dhe bazën ligjore. Në këto tri dokumente rezultojnë të pasqyruara shkaqet e parashtruara në ankimin e depozituar nga pala paditëse në Gjykatën Administrative të Apelit ndaj vendimit të dhënë nga: (i) Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë (shihni dokumentin 1 dhe dokumentin 3), (ii) Gjykata e Apelit Durrës (dokumenti 2) - pretendimet e paraqitura nga pala paditëse ankuuese në të tria draft-relacionet janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në mënyrë të saktë, por konstatohet se në dokumentin 1 nuk ka mendim/sugjerim/rekomandim të vetë ndihmësit ligjor për zgjidhjen e çështjes, por vetëm referim tek arsyetimi i vendimit të shkallës së parë. Në

⁶⁶ Dokumenti 1. Draft-relacion për çështjen administrative nr. *** regj., datë 23.10.2014, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditëse shtetasja L.D kundër të paditurit Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme T. Dokumenti 2. Draft-relacion për çështjen administrative nr. *** regj., datë 6.11.2014, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditëse shoqëria “****” sh.p.k. kundër të paditurit Inspektorat Ndërtimor Urbanistik Kombëtar. Dokumenti 3. Draft-relacion për çështjen administrative nr. *** regj., datë 6.7.2015, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditëse shoqëria “****” sh.p.k., kundër të paditurve Drejtoria Rajonale Tatimore T dhe Drejtoria e Apelit Tatimor.

⁶⁷ Me shkresën nr. ***, datë 2.8.2021, depozituar në raportin profesional të subjektit, administruar nga Komisioni.

dokumentin 2 konstatohet sugjerim/rekomandim për zgjidhjen e çështjes, pra jo referim tek arsyetimi i vendimit të shkallës së parë. Në dokumentin 3 konstatohet se në një paragraf më vete ndihmësja ligjore ka dhënë mendimin konkret se padia e paraqitur nga pala paditëse duhet të rrëzohet si e pabazuar në prova e në ligj. Dokumenti është përzgjedhur jashtë periudhës së rivlerësimit. Në tri draft-vendimet nuk pasqyrohet data e përpilimit të tyre, ato janë konceptuar dhe firmosur nga subjekti i rivlerësimit, por jo nga gjyqtarja relato e çështjeve, e cila nuk rezultoi ta ketë refuzuar apo të mos e ketë pranuar përmbajtjen e tyre.

33.4 Komisioni kërkoi⁶⁸ nga Gjykata Administrative e Apelit tri vendimet gjyqësore të dhëna për këto çështje. Nga analiza krahasuese e tri vendimeve të Gjykatës⁶⁹ dhe tri relacioneve të konceptuara nga subjekti i rivlerësimit rezultoi se relacionet e konceptuara nga subjekti (dokumenti 1, 2 dhe 3) janë përpiluar saktë dhe gjenden të pasqyruara njësoj në 3 vendimet gjyqësore të dhëna. Ndryshimi qëndron se në draft-relacion (dokumenti 2) subjekti i rivlerësimit pas paraqitjes së palëve, objektit të padisë dhe bazës ligjore ka renditur shkaqet e parashtruara në ankim nga pala e paditur, ndërsa në vendimin e Gjykatës ato janë vendosur pas vlerësimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

33.5 Sa më sipër, në përfundim të analizës së kryer për tri dokumentet e përzgjedhura, Komisioni nuk konstatoi problematika thelbësore lidhur me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

34. Përshkrimi i 5 dokumenteve ligjore të përzgjedhura me short për ndihmësen ligjore Alma Troshani

Dokumenti 1. Çështja administrative me nr. *** akti, datë 28.7.2015, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës D.M kundër të paditurve Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë dhe Komisariati i Policisë Rrugore Tiranë, me objekt “Shfuqizimi i vendimit nr. ***, datë 25.5.2015, i Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë”, e përfunduar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. ***, datë 7.9.2015.

Dokumenti 2. Çështja administrative me nr. *** akti, datë 7.1.2016, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditëse T.H, kundër të paditurve Agjencia e Legalizimit, Drejtoria T ***, V.M etj., me objekt “Detyrimi i të paditurve të përfshijnë paditësen në procesin e legalizimit të objektit informal “shtesë anësore” të ndodhur në Rrugën e ***, Njësia Nr. ***, Tiranë, në cilësinë e bashkëpronarit”, e përfunduar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. ***, datë 18.3.2016.

Dokumenti 3. Çështja administrative me nr. *** akti, datë 15.7.2015, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditëse O.S, kundër të paditurit Bashkia e T, Zyra e Gjendjes Civile, me objekt “Korrigjimi i regjistrimit themeltar nr. ***, të aktit të martësës nr. ***, datë 25.8.1999, për sa i përket rubrikave të amësisë dhe mbiemrit të vajzërisë së O.S”, e përfunduar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. ***, datë 6.10.2015.

Dokumenti 4. Çështja administrative me nr. *** akti, datë 13.11.2015, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës F.M, kundër të paditurit Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Zyra Rajonale e Sigurimeve Shoqërore T, me objekt “Anulimin e vendimit të pakonfirmuar, njohur me shkresën nr. ***, datë 10.7.2015, të DRSSH-së, për ndërprerjen e pensionit të pleqërisë dhe detyrimin e të paditurit të më rilidhë pensionin e ndërprerë padrejtësisht dhe dëmshpërblimin nga data e ndërprerjes deri në rifillimin e pagesës së pensionit”, e përfunduar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. ***, datë 21.1.2016.

Dokumenti 5. Çështja administrative me nr. *** akti, datë 6.7.2015, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës R.SH, kundër të paditurit Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, me objekt “Konstatimi

⁶⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.2.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 28.2.2024. Tri vendimet e depozituara nga Gjykata Administrative e Apelit, administruar në dosjen e Komisionit.

i zgjidhjes së kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme e të pajustificuar. Detyrimin për dëmshpërblim për mosrespektim të procedurës etj.”, e përfunduar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. ***, datë 1.10.2015.

34.1 Nga aktet e vëna në dispozicion nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe në bazë të nenit 6 të ligjit nr. 49/2012, në dosjet gjyqësore rezulton se:

i) Nuk është përfshirë ndonjë akt që të dokumentojë ndihmën dhe këshillimin që ndihmësja ligjore Alma Troshani u ka dhënë gjyqtarëve E.R dhe E.R lidhur me përgatitjen e çështjeve për gjykim dhe shqyrtim gjyqësor;

ii) Nuk është përfshirë përgatitja e ndonjë projektakti procedural të nevojshëm për gjykimin, që të mbajë nënshkrimin në cilësinë e konceptuesit prej ndihmësës ligjore Alma Troshani;

iii) Nuk është përfshirë ndonjë kërkesë nga gjyqtarët E.R dhe E.R drejtuar ndihmësës ligjore për të bërë kërkime ligjore apo për të hartuar opinion me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material, që lidhen me çështjet në fjalë. Rrjedhimisht, në dosje nuk rezultojnë të administruara akt-kërkime ligjore apo opinione me shkrim nga vetë ndihmësja ligjore Alma Troshani.

Hetimi i Komisionit për 5 dosjet e përzgjedhura me short

34.2 Në analizë të 5 dokumenteve (relacioneve)⁷⁰ të përzgjedhura me short duket se nga pikëpamja formale ato rezultojnë të jenë përgatitur dhe përpiluar në përputhje me parashikimet e nenit 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012⁷¹.

34.3 Në analizë të 5 dosjeve⁷² të përzgjedhura me short vihet re se:

- a) Janë përzgjedhur brenda periudhës së rivlerësimit të subjektit dhe nga të dhënat e depozituara në raportin profesional rezultoi se të pestë dokumentet e shortuara u përkasin çështjeve të gjykuara në Gjykatën e Apelit të Shkallës së Parë Tiranë.
- b) Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë informon⁷³ se subjekti i rivlerësimit është caktuar të kryejë detyrën e ndihmësit ligjor pranë gjyqtarëve E.R dhe E.R.
- c) Nga hetimi fizik i pesë dosjeve të dala nga shortimi, Komisioni konstaton se: (i) nuk rezultojnë akte administrative të nënshkruara nga ndihmësja ligjore, të tilla si relacione, draftvendime, opinione ligjore etj; (ii) nuk është përfshirë ndonjë kërkesë nga gjyqtarët E.R dhe E.R drejtuar ndihmësës ligjore (subjektit), për të bërë kërkime ligjore apo për të hartuar opinion me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material, që lidhen me çështjet në fjalë.

⁷⁰ Dokumenti 1. Çështja administrative nr. *** akti, datë 26.11.2015. Dokumenti 2. Çështja administrative nr. *** akti, datë regjistrimi 23.10.2014. Dokumenti 3. Çështja administrative nr. *** akti, datë 1.6.2015. Dokumenti 4. Çështja administrative nr. ***akti, datë 8.10.2014. Dokumenti 5. Çështja administrative nr. *** akti, datë 28.10.2014.

⁷¹ Ligji nr. 49/2012, neni 6, pika 2. “*Ndihmësi ligjor ndihmon dhe këshillon gjyqtarin lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor, si dhe përgatit projektakte procedurale të nevojshme për gjykimin. Me kërkesë të gjyqtarit, ndihmësi ligjor bën kërkime ligjore dhe përgatit opinione me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material që lidhen me çështjet në gjykim*”.

⁷² Dokumenti 1. Çështja administrative nr. *** akti, datë 28.7.2015, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës D.M, kundër të paditurve Drejtoria e Policisë e Qarkut T dhe Komisariati i Policisë Rrugore T. Dokumenti 2. Çështja administrative nr. *** akti, datë 7.1.2016, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditëse T.H, kundër të paditurve Agjencia e Legalizimit, Drejtoria Tirana ***, V.M etj. Dokumenti 3. Çështja administrative nr. *** akti, datë 15.7.2015, që u përket palëve ndërgjyqëse - paditëse O.S, kundër të paditurit Bashkia e Tiranës, Zyra e Gjendjes Civile. Dokumenti 4. Çështja administrative nr. *** akti, datë 13.11.2015, që u përket palëve ndërgjyqëse - paditës F.M, kundër të paditurit Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Zyra Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë. Dokumenti 5. Çështja administrative nr. *** akti, datë 6.7.2015, që u përket palëve ndërgjyqëse - paditës R.SH, kundër të paditurit Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.

⁷³ Me urdhrin nr. ***, datë 10.6.2015, për shpërndarjen e ndihmësve ligjorë trupit gjykues, depozituar në raportin profesional të subjektit, administruar nga Komisioni.

Rrjedhimisht, në dosje nuk rezulton i administruar ndonjë akt kërkimi ligjor apo opinion me shkrim nga vetë ndihmësja ligjore.

- d) Komisioni lidhur me konstatimet e tij, bazuar edhe në nenin 6 të ligjit nr. 49/2012, kërkoi informacion⁷⁴ në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila informon⁷⁵ se: *“Puna e ndihmësve ligjorë pranë kësaj gjykate nuk është e përcaktuar me akte ligjore apo nënligjore dhe, në kushtet e mungesës së njësisve matëse të përcaktuar me ligj, në dosjet gjyqësore nuk rezulton të ketë dokumentacion provues të kërkimeve ligjore, hartimin e opinioneve me shkrim, përgatitjen e ndonjë projektakti të nevojshëm për gjykim, që të mbajë nënshkrimin e znj. Alma Troshani në cilësinë e konceptueses”.*
- e) Gjykata nga ana e saj ka kërkuar informacion nga subjekti i rivlerësimit, znj. Troshani, për këtë çështje. Znj. Troshani ka bashkëngjitur me informacionin e ardhur nga gjykata përgjigjen e saj, në të cilën sqaron se ka ushtruar detyrën e ndihmësës ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë për periudhën 8.6.2015 – 5.4.2016. Më pas është emëruar dhe ka ushtruar të njëjtën detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit. Detyrën e saj e ka ushtruar në kuadër të parashikimeve të ligjit nr. 49/2012, përkatësisht nenet 5,6 dhe 6/1 të këtij ligji, i ndryshuar, për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, dispozita të cilat më pas u shfuqizuan me ligjin nr. 39/2017. Subjekti i rivlerësimit në përgjigjen e saj sqaron: *“Gjykata Administrative e Shkallës së Parë dhe Gjykata Administrative e Apelit për ndihmësin ligjor nuk kishin të hartuar ndonjë rregullore të brendshme për mënyrën se si ndihmësi ligjor duhej të operonte me gjyqtarin, ku e dorëzonte relacionin për çështjen, ku i dokumentonte opinionet e tij ligjore, mënyrën se si i përgatiste projektvendimet dhe ku i dorëzonte, kjo jo për faj të ndihmësit ligjor, por të mënyrës se si operonte gjykata, qoftë edhe në mungesë të një urdhri të titullarit të gjykatës, lidhur me punën e ndihmësit ligjor”.* Ajo ka konfirmuar ekzaktësisht: *“...Asnjëherë materialet e përgatitura nga ana jonë nuk janë bërë pjesë e dosjes gjyqësore apo të jenë protokolluar me protokoll të brendshëm për t’u ruajtur më pas në gjykatë. Në mungesë të të tillave parashikime dhe detyrime, marrëdhënia jonë me gjyqtarin pranë të cilit ishim emëruar, ishte tërësisht personale. Ne përgatisnim aq sa na kërkohet nga ana e tyre, përfshirë këtu relacionet, projektvendimet, pjesën arsyetuese të vendimeve, kërkime të nxjerra nga praktika e Gjykatës së Lartë lidhur me çështjet në gjykim, por asnjëherë aktet e përgatitura nga ana jonë janë ruajtur apo janë bërë pjesë e dosjeve gjyqësore. Të vetmet materiale që mund të kemi, janë komunikimi me email me gjyqtarët respektivë, email-e të cilat mund të mos jenë ruajtur, për shkak se ka kaluar shumë kohë”.* Subjekti ka bashkëngjitur një email datë 21.7.2016, ku konstatohet se i ka dërguar gjyqtarit E.R një material të emërtuar “D.M me Drejtorinë...” nga email-i i saj personal, sepse në atë periudhë ndihmësit ligjor nuk kishin email zyrtar.
- Në përfundim të analizës së kryer për 5 dokumentet e përzgjedhura me short, Komisioni nuk konstatoi problematika thelbësore lidhur me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.
- f) Nga hetimi i Komisionit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykata Administrative e Apelit informojnë⁷⁶ se nuk rezultojnë të dhëna negative për etikën në punë të subjektit të rivlerësimit, për periudhën gjatë së cilës ajo ka ushtruar detyrën e ndihmësës ligjore pranë këtyre gjykatave. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë objekt i ndonjë procedimi disiplinor për shkelje disipline.

⁷⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.2.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 26.1.2023 dhe shkresën nr. *** prot., datë 27.1.2023, depozituar në raportin profesional të subjektit, administruar nga Komisioni.

- g) Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK)⁷⁷ informon se në emër të subjektit të rivlerësimit, shtetases Alma Troshani, nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

Lidhur me kriterin e dytë vlerësues, rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës

35. Shkolla e Magjistraturës ka dërguar⁷⁸ rezultatet e testimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*, parashikuar në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës⁷⁹ dhe sipas parashikimeve të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016⁸⁰ “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti i rivlerësimit Alma Troshani nga verifikimi i tabelave të rezultateve konstatohet se në fazën e parë të testimit të aftësive profesionale “Testi elektronik”, është vlerësuar me 49 pikë, nga 100 pikë të mundshme, ndërsa në fazën e dytë “Testi profesional” është vlerësuar me 141 pikë në tabelë, nga 200 pikë të mundshme.

35.1 Nga verifikimi i regjistrit të denoncimeve, nuk rezultoi që të jenë depozituar ankesa nga publiku në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Alma Troshani.

Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

36. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u provuan indicie apo element që cenon kriterin profesional të ndihmëses ligjore znj. Alma Troshani dhe, sipas parashikimeve të nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është efektive dhe eficiente në masë të pranueshme dhe, përfundimisht, u vlerësua “e aftë” për kriterin profesional.

VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara prej saj, çmon se:

- a) Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.
- b) Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është hetuar/arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c) Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

⁷⁷ Me shkresën nr. *** prot. (D. B.), datë 5.3.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.5.2018, administruar nga Komisioni.

⁷⁹ Kushtetuta e Shqipërisë, neni 179/b, pika 4. “Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen *ex officio*. Procesit të rivlerësimit mund t’i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish-prokurorët, ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet”.

⁸⁰ Ligji nr. 84/2016, neni 42. “Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; b) rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës”.

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Troshani, ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë.
 2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtar, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
 3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
 4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në Tiranë, më 9.9.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU
Kryesuese

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Olsi KOMICI
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka